

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Lënda numër : PKRNR 942/13

11 Mars 2014

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons, Kryetarë i Trupit Gjykues dhe gjyqtari Faik Hoxha si dhe gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser, anëtarë të trupit gjykues dhe Sonila Macneil, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit:

A. V., mashkull, i lindur më xxx në xxx, emri i babait xxx, emri i nënës xxx (i vajzërisë xxx), numri i pasaportës xxx, shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës, me banim në xxx, i papunë, me profesion tregtar, me arsim të mesëm, i martuar, me gjendje ekonomike mesatare, në paraburgim që nga 23 janar 2013;

I akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë speciale të EULEX-it PPS Nr. 42/2012 të datës 16 Shtator 2013 dhe të ngritur më 16 shtator 2013, aktakuzë kjo e ndryshuar më 1 Tetor 2013 dhe 7 Mars 2014, me këto pika të Akuzave:

Akuza 1

Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës¹ vepër kjo për të cilën parashihet dënim me gjobë dhe burgim prej tri deri në pesëmbëdhjetë vjet

SEPSE mes të 1 Janarit 2012 dhe 21 Shkurtit 2012, A.V. në territorin e Kosovës ka kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope duke organizuar dhe marrë pjesë në blerjen, shitjen, transportimin, dërgimin, eksportimin nga Kosova dhe importimin për në Republikën Federale të Gjermanisë, përmes vendeve të tjera në Evropë të një dërgese prej 1,496 kg heroinë, si anëtar i një grupi, heroinë kjo e sekuestruar në 20 shkurt 2012 në Mynih, e gjetur në një automjet Toyota Corolla me numër regjistrimi xxx, heroinë kjo e pranuar në Mynih nga L.G., D.K. dhe M.K., në bashkë-kryerje, në bazë të nenit 23 të Kodit Penal të Kosovës.

¹ Që korespondojnë me nenet 273 dhe 279 të Kodit penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 të vitit 2012 (Kodi i ri)

Akuza 2

Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës² veprë kjo për të cilën parashihet dënim me gjobë dhe burgim prej tri deri në pesëmbëdhjetë vjet .

SEPSE mes 1 majit 2012 dhe 1 korrikut 2012, A.V. në territorin e Kosovës ka kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope duke organizuar dhe marrë pjesë në blerjen, shitjen, transportimin, dërgimin, eksportimin nga Kosova dhe importimin për në Republikën Federale të Gjermanisë, përmes vendeve të tjera në Evropë të një dërgesë prej 1.436 kg heroinë, si anëtar i një grupi, heroinë kjo e sekuestruar më 10 qershor 2012 në Mynih të Gjermanisë, e gjetur në një automjet Opel Astra me numër regjistrimi serb XXX, heroinë kjo e pranuar nga R.A., O.B. dhe L.Z., në bashkëkryerje, në bazë të nenit 23 të Kodit penal të Kosovës.

Akuza 3

Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Kodit penal të Kosovës³ (më tej "KPK") veprë kjo për të cilën parashihet dënim gjobë deri në 500.000 € dhe burgim prej shtatë deri në njëzet vjet .

SEPSE mes 1 janarit 2012 dhe 1 korrikut 2012, A.V.T në territorin e Kosovës ka kryer veprën penale të krimit të organizuar duke kryer veprë kriminale të rëndë, përkatësisht blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm, duke organizuar dhe marrë pjesë në blerje, shitje, transportim, dërgim, eksportim nga Kosova dhe importim për në Republikën Federale të Gjermanisë të dy dërgesave të heroinës, konkretisht, 1,496 kg heroinë e sekuestruar më 20 shkurt 2012 në Mynih të Gjermanisë, tek një automjet Toyota Corolla me numër regjistrimi XXX dhe 1.436 kg të sekuestruar më 10 qershor 2012 në Mynih të Gjermanisë, tek një automjet Opel Astra me numrin e regjistrimit serb xxx; brenda një grupi të strukturuar së bashku me L.G.N, M.K.N, D.K.N, G.Y., F.F., O.B., L.Z., R.A. dhe bashkë-kryesë të tjerë të pidentifikuar; duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grupin kriminal; dhe duke organizuar, formuar, mbikëqyrë, menaxhuar ose drejtuar aktivitetet e grupit, me qëllim të përfitimit, direkt ose indirekt, financiar apo ndonjë përfitimi tjetër material.

Pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit gjyqësor më 19, 21,27 nëntor; 4 dhe 11 dhjetor 2013; 6 dhe 8 janar; 19 shkurt dhe 7 mars 2014, në praninë e të akuzuarit A.V., avokatit të tij mbrojtës A.H. dhe në praninë e prokurorit special të EULEX-it Andrew Carney nga Prokuroria Speciale e Kosovës;

² Që korespondojnë me nenet 273 dhe 279 të Kodit penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 të vitit 2012 (Kodi i ri)

³ Që korespondon me nenin 283 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 të vitit 2012

Pas këshillimit vendim-marrës dhe votimit të mbajtur më 11 mars 2014;

Në bazë të nenit 362 paragrafi 1, nenit 365 dhe nenit 366 të Kodit të procedurës penale të Kosovës sot më 11 mars 2014, në gjykatë të hapur dhe në prani të të pandehurit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit special të EULEX-it, lëshon këtë

AKTGJYKIM

A.V., me të dhënat personale si më sipër, në paraburgim që nga 23 janari 2013 shpallet:

FAJTOR

SEPSE mes 1 janarit 2012 dhe 10 qershorit 2012, i pandehuri në territorin e Kosovës ka organizuar dhe ka marrë pjesë në blerje, posedim, shitje, transportim, dërgim, eksportim nga Kosova dhe importim për në Republikën Federale të Gjermanisë të dy dërgesave të heroinës, konkretisht, 1,496 kg heroinë e sekuestruar më 20 shkurt 2012 në Mynih të Gjermanisë⁴, tek një automjet Toyota Corolla me numër regjistrimi XXX të cilin e drejtonte M.K. ku gjindej edhe D.K. si dhe 1.436 kg heroinë e sequestruar më 10 qershor 2012 në Mynih të Republikës Federale të Gjermanisë⁵, tek një automjet Opel Astra me numër regjistrimi xxx të cilin e ngiste R.A. dhe e gjetur në posedim të R.A., O.B. dhe L.Z.; brenda një grupi të strukturuar së bashku me L.G.n, M.K., D.K, G.Y., O.B., L.Z., R.A. dhe bashkë-kryesë të tjerë të paidentifikuar; duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grupin kriminal; dhe duke organizuar, formuar, mbikëqyrë, menaxhuar ose drejtuar aktivitetet e grupit në fjalë, me qëllim të përfitimit, direkt ose indirekt, financiar apo ndonjë përfitim tjetër material⁶.

Duke kryer **në këtë mënyrë**, në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të Kodit penal të Republikës së Kosovës⁷, veprën penale të krimit të organizuar në shkelje të nenit 274 paragrafi 1 dhe 3 i KPK-së në lidhje me veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bazë të nenit 229, paragrafi 3 të KPK-së.

Duke qenë i dënuar për veprën penale të krimit të organizuar nga neni 274 paragrafi 1 dhe 3 i KPK-së në lidhje me veprën penale blerjes, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 229, paragrafi 3 të KPK-së, në mbështetje të neneve 3, 34, 38, 39, 64, 65 dhe 274 (3) të KPK-së, i pandehuri, A.V., është dënuar me një dënim prej **10 (dhjetë) vite me burgim dhe me dënim me gjobë në shumë 20,000 (njëzet mijë) Euro**, e cila duhet të paguhet brenda 30 diteve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

⁴ Akuza 1

⁵ Akuza 2

⁶ Akuza 3

⁷ Ligji 04/L-082 e vitit 2012

Në bazë të nenit 73 (1) të KPK-së koha e kaluar në paraburgim nga 23 janari 2013 deri me këtë datë këtu do të llogaritet në dënim.

Në bazë të të neneve 450, 451 dhe 453 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i akuzuari i i bart shpenzimet e procedurës penale të vlerësuara në shumën prej 4.600 (katër mijë e gjashtëqind) Euro⁸ së bashku me paushallin, të vlerësuar në shumën prej 500 (pesëqind) Euro.

Çdo kërkesë pronësore juridike do të shqyrtohet nëpërmjet gjykatave civile.

Më tej, paraburgimi me anë të kësaj i vazhdohet derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, për shkak se rreziku i arratisjes ende ekziston siç parashihet me nenin 187, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.2.1 të KPPK-së, por jo më shumë se skadimi i afatit të dënimit të caktuar në këtë aktgjykim. Një aktvendim i veçantë do të lëshohet mbi paraburgimin.

ARSYETIMI

PËRMBAJTJA

CONTENTS

A. Hyrje	9
i. Sfondi Procedural	9
ii. Ligjëshmëria	11
B. Ligji	12
C. Konsiderimet në lidhje me Vlerësimin e Provave	17
i. Barra dhe Standardi i të provuarit	17
D. Shqyrtimi I Provave	17
i. Analizat e Zërit	18
ii. Akuzat 1 dhe 3	23
a. Komunikimet Telefonike	23
b. Bastisjet	dhe
Arrestimet.....
.....	33
iii. Akuzat 2 dhe 3	41
a. Komunikimet Telefonike	41

⁸ Ku duhet përfshirë shumën prej 3000 (tri mijë) funtave britanike që I janë paguar P.B. nga Shërbimet forenzike audio për raportin e tij të darës 17 dhjetor 2013 dhe 100 (një qind) euro për dëshminë që e ka dhënë nga Mbretëria e Bashkuar me video link më 19 shkurt 2014.

b. Bastisjet dhe Arrestimet.....	53
iv. Dëshmitë e dëshmitarëve	59
v. Deklaratat.....	61
E. Konstatimet mbi Përgjegjësinë e të Akuzuarit	62
F. Dënimi	71
MJETET LIGJORE.....	75
SHTOJCA I Dëshmite e Dëshmitarëve	77
SHTOJCA II Provat e Parashtruara nga Prokuroria	78
SHTOJCA III Provat e Parashtruara nga Mbrojtja	

Këto shtojca përbëjnë pjesë përbërëse të këtij Aktgjykimi.

A. HYRJE

i. Sfondi Procedural

Më 11 Maj 2012, Prokuroria lëshoi një Aktvendim mbi Fillimin e Hetimeve kundër A.V. (në tekstin e mëtejme “i pandehuri”), si dhe vëllai i tij Y.J. (i njohur më parë si V.). Në të njëjtën datë, një letër mirëbesimi ishte lëshuar nga Policia e Njësisë mbi Krimin e Organizuar të EUELX-it si dhe Drejtoria për Krimin e Organizuar në Policinë e Kosovës.

Më 17 Gusht 2012, Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “ PSRK”) mori një Kërkesë nga Prokurori Publik në Mynhen, Republika Federale e Gjermanisë me datë 22 Korrik 2012, në lëndën me Nr. referenceË 371 J.S.: 138867/11 mbi transferimin e procedurës penale kundër Y.V. (J), të të pandehurit dhe një të dyshuari tjetër.⁹

Më 11 Prill 2013 , një Aktakuzë ishte ngritur tek Gjykata Themelore e Prishtinës kundër Y J sipas numrit të lëndës PPS 42/2012. Edhe pse i pandehuri ishte hetuar sipas të njëjtit numër të lëndës dhe si pjese e procedurës së Y.J., teksa hetimi po ecte, edhe pse veprat qe pretendohen të

⁹ E proceduar përmes Ambasadës të Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë, Ref: R.K. 531/191 Y. me datë 26 Korrik 2012, dhe Ministria e Drejtësisë së Kosovës, Departamenti për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtarë Ref: Moj/DBJN/03100A/12, DLA/2012-01140 të datës 13 Gusht 2012.

jenë kryer nga i pandehuri dhe Y.V. ishin të njëjta dhe ishin në të njëjtin modus operandi, u bë e qartë se të dyshuarit tjerë që kishin të bënin me secilin nga të pandehurit ishin ndryshe si dhe periudha e kryerjes së veprave nga të pandehurit ishte ndryshe nga ajo e Y.J. Në këto rrethana kundër Y.J. dhe të pandehurit ishin ngritur dy aktakuza ndaras.

Aktakuza kundër të Pandehurit mban datën 16 Shtator 2013 dhe ishte ngritur më 17 Shtator 2012.

Aktakuza ishte ndryshuar më 1 Tetor 2013 që të përmirësohet një gabim shtypi për datën e Akuzës 2 që i referohej “ 01 Korrik 2010”, kur, në fakt, ishte e qartë në aktakuzë se data e saktë ishte 1 Korrik 2012. Aktakuza ishte ndryshuar përputhshmërisht.

Më 7 Mars 2014 Prokuroria e ndryshoi aktakuzën me tutje në mënyrë që të ndryshohet periudha në pikën 2 në 1 Prill-1 korrik 2012 si dhe periudhën në Akuzën 3 në 1 Janar -11 Qershor 2012.

ii. Ligjshmëria

Neni 11 i Ligjit mbi Gjykatat ¹⁰ thotë se Gjykata Themelore është kompetente që të gjykoj në shkallën e parë në të gjitha rastet, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.

Neni 15 i ligjit në fjalë thotë se Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore ka juridiksion që të gjykojë në shkallën e parë në rastet që kanë të bëjnë me blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm ose substancave psikotropike, krim të organizuar, duke përfshirë frikësimin gjatë procedurës penale për krim të organizuar dhe cilin do rast që bije brenda kompetencave ekskluzive apo suplementare të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës sipas Ligjit mbi Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës. ¹¹

I pandehuri ishte ngarkuar me dy pika të akuzave për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm ose substancave psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1,2,3 dhe 4 si dhe Krim të Organizuar, në kundërshtim me Nenin 274, paragrafët 1,2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës.

Veprat ishin kryer në Kosovë. I pandehuri ishte duke banuar në Kosovë gjatë gjithë kohës në Prishtinë. Në pajtim me Nenin 9 të Ligjit në fjalë, Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje bie nën juridiksion të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Për këtë, Gjykata Themelore e Prishtinës ka juridiksion territorial.

Në pajtim me Nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksionin ¹² gjyqtarët e EULEX-it duhet të kenë juridiksion mbi cilin do rast që përndiqet nga PSRK-ja.

¹⁰ Ligji Nr. 03/L-199

¹¹ Nr. 03/L-52 (13 Mars 2008)

¹² Nr. 03/L-53

B. LIGJI

I pandehuri është ngarkuar me tri pika në Aktakuzë.

Në pikat 1 dhe 2 ai u ngarkua me blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm ose substancave psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1,2,3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës¹³. Në pikën 3 ai u ngarkua me Krim të Organizuar, në kundërshtim me Nenin 274, paragrafët 1,2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës.¹⁴

Pasi që veprat penale janë kryer ka ndërruar edhe ligji penal në Kosovë. Më 1 Janar 2013 Kodi i Ri Penal i Kosovës¹⁵ (në tekstin e mëtejshëm “KPRK”-së) hyri në fuqi.

Në përcaktimin se cili kod penal të aplikohet Trupi Gjykes kishte pasur parasysh për parimin e mirë krijuar se ligji i cili është më i favorshmi për të pandehurin duhet të aplikohet.¹⁶

Me përcaktimin e ligjit më të favorshëm Trupi Gjykes kishte parasysh kufijtë e dënimeve dhe fajësinë e të pandehurit brenda kufijve të përshtatshëm për dënim.¹⁷ Në lidhje me këtë, është e papërshtatshme që thjesht të i referohemi dënimeve minimume apo maksimume të cilat janë në ligj.

Pas marrjes parasysh të ndryshimeve pasuese të kodit penal, Trupi Gjykes konstaton se ndryshimet substanciale pasuese të kodit penal nuk janë më të favorshme për të pandehurin. Kështu që, Trupi Gjykes aplikoi ligjin substancial që ishte në fuqi në kohën kur ishin kryer veprat.

i. Dispozitat e Zbatueshme të Kodit Penal

Nën pikat 1 dhe 2 i pandehuri ishte akuzuar me blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm ose substancave psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1,2,3 dhe 4 dhe Nenin 23 të KPK-së, të dënueshme me gjobë dhe burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vite.

Neni 229 i KPK-së thotë:

(1) *Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim shitje, shpërndarje ose ofron për shitje substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë dhe substanca psikotropike dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në pesë vjet.*

¹³ Që korrespondojnë me Nenet 273 dhe 279 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-082 i 2012-tës

¹⁴ Që korrespondojnë me Nenet 283 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-082 i 2012-tës

¹⁵ Nr. 04/L-082

¹⁶ Neni 2 (2) i KPK-së dhe Neni 3 (2) i KPPK-së

¹⁷ Makatouf and Damjanovic V. Bosnia and Hercegovina GJEDNJ, Korrik 2013 (Kërkesat nr. 2312/08 dhe 34179/08)

(2) *Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.*

(3) *Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotropike dënohet me gjobë dhe burgim prej tre deri në dhjetë vjet.*

(4) *Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2, ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet kur:*

- 1) Kryerësi vepron si anëtar i një grupi;*
- 2) Kryerësi është anëtar i forcave policore ose përgjegjës për zbatimin e ligjit;*
- 3) Kryerësi është person zyrtar i cili vepron gjatë ushtrimit të detyrave të tij;*
- 4) Kryerësi përdor ose kërcënon se do ta përdorë dhunën ose armën gjatë kryerjes së veprës;*
- 5) Vepra kryhet duke e shfrytëzuar fëmijën ose në dëm të personit të tillë;*
- 6) Vepra është kryer kundër personit posaçërisht të ndjeshëm si rezultat i moshës, sëmundjes, paaftësisë fizike apo mendore ose çrregullimit apo shtatzanisë, gjë që ka qenë një fakt i njohur ose i dukshëm për kryerësin;*
- 7) Dërgesa, ngarkesa, kontejneri ose mjeti i planifikuar për një operacion humanitar është përdorur për transportimin e paligjshëm të narkotikëve ose të substancave psikotropike;*
- 8) Personi ka përzier substancat narkotike dhe psikotropike me substanca të tjera, me ç' rast ka shtuar rrezikun për shëndetin e njeriut dhe*

9) *Personi e intoksikon personin tjetër me substanca narkotike ose psikotropike pa dijeninë e tij.*

(5) *Narkotikët dhe substancat psikotropike konfiskohen.*

Nën Akuzën 3 i pandehuri është ngarkuar me Krim të Organizuar , sipas Nenit 274 paragrafët 1,2 dhe 3 të KPK-së , i dënueshëm me gjobë deri në 50,000 Euro apo burgim prej shtatë deri në njëzet vite.

Neni 274 i KPK-së përcakton:

(1) *Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet.*

(2) *Kushdo që aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitete të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar dënohet me burgim së paku pesë vjet.*

(3) *Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobën deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.*

(4) *Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 EUR dhe me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë nëse veprimtaria e grupit të organizuar rezulton me vdekje.*

(5) *Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin i cili kryen veprë penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni nëse personi i tillë, para se grupi të kryejë veprën, e lajmëron policinë apo prokurorin publik në hollësi lidhur me ekzistimin, përbërjen dhe informacionet e grupit të organizuar për t'i mundësuar policisë arrestimin e grupit apo prokurorit publik ndjekjen e*

atij grupi.

(6) Kushdo që është dënuar me dënime plotësuese nga neni 57 i këtij Kodi për kryerjen e veprës penale nga ky nen dhe i shkel kushtet e atyre dënimeve plotësuese, dënohet me burgim deri në një vit.

(7) Sipas këtij neni,

1) Shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare;

2) Shprehja “grup kriminal i organizuar” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare;

3) Shprehja “krim i rëndë” do të thotë veprë penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet dhe

4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë veprë penale dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

Neni 23 i KPK-së përcakton:

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.

C. MARRJA NË KOSIDERATË E VLERËSIMIT TË PROVAVE

I. Barra dhe shkalla e të provuarit

Neni 6 (2) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (që këtej e tutje “KEDNJ”, Kushtetuta e Kosovës dhe Neni 3 (1) parashikojnë prezumimin e pafajësisë që i pandehuri ka të drejtë. Ky prezumim i vë barrën Prokurorisë që të vërtetoj fajësinë e të pandehurit, një detyrë që e ka Prokuroria gjatë gjithë gjykimit.

Neni 370 (7) i KPP-së thekson se ‘Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara’. Prandaj, Trupi Gjykues duhet të përcaktoj nëse ai është i kënaqur duke u bazuar në të gjitha provat, pra, që të jetë i sigurtë, se çdo element i krimit është vërtetuar. Çdo dyshim, duhet të shkoj në favor të pandehurit.

Trupi Gjykues, në mbështetje të Nenit 7 (1), (2) të KPP-së ‘detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm’... detyrohet që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në ... favor ... të tij’.

G. VLERËSIMI I PROVAVE

Pretendohet në Aktakuzë se i pandehuri ka organizuar furnizimin, eksportimin dhe transportimin e heroinës nga Kosova në Gjermani, duke e fshehur drogën në makina, para se të transportohej nga korrierë e të shpërndahej përfundimisht tek përdoruesit.

Rasti i Prokurorisë thelbësisht është bazuar në përgjimet telefonike të caktuara dhe të zbatuara në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe në përgjimet telefonike të caktuara dhe të zbatuara në Kosovë.

Ndërsa arsyetimi i të pandehurit ishte se ai nuk ishte trafikant i narkotikëve, i cili ishte inçizuar nga policia gjatë përgjimeve të ndryshme telefonike, si dhe personi që kishte dërguar dhe pranuar tekst-mesazhe të ndryshme për të rregulluar furnizimin e drogës.

Në korrik 2010 , policia në Gjermani filloi “Operacionin Merimanga”¹⁸. Gjatë zhvillimit të operacionit, policia siguroi një sasi të konsiderueshme provash kundër të Pandehurit dhe personave të tjerë që shoqëroheshin me të. Provat përbëhen nga përgjimet e komunikimeve

¹⁸ Merimanga

telefonike, prova nga vëzhgimi, prova të siguruara pas arrestimit të të dyshuarve si dhe sekuestrim i dy ngarkesave të heroinës më 20 Shkurt 2012 dhe më 10 Qershor 2012.

I Pandehuri u arrestua në Kosovë më 23 Janar 2013.

Gjykata ka vlerësuar provat në mënyrë kronologjike, në të njëjtin format si në Aktakuzë.

Duke marrë parasysh rëndësinë themelore të provave të mbledhura përmes urdhëresave të ndryshme për përgjim telefonik, Trupi Gjykues do të shqyrtoj dhe vlerësoj këto prova si një çështje ‘paraprake’.

Analizat e zërit

Gjatë hetimit, Gjykata e shkallës së parë në Munih, në Republikën Federale të Gjermanisë caktoi masën për përgjime të fshehta telefonike të komunikimeve të bëra për numrat telefonik xxx, xxx, xxx, xxx, xxx, xxx dhe xxx¹⁹.

Sipas Prokurorisë, këto numra telefonik kanë qenë në posedim dhe përdorim të të pandehurit. Kjo është mohuar nga ana e të pandehurit.²⁰

Meqenëse provat e siguruara përmes përgjimit të këtyre numrave telefonik ishin thelbësore për rastin e Prokurorisë, dhe përbënte vërtetim të fakteve në fjalë, Trupi Gjykues kërkoi mendimin e ekspertit të një audiologjisti forenzik, të Z. P.B. nga Shërbimet e Forenzikës të Audios. Z. B. dëshmoi para Trupit Gjykues më 19 Shkurt 2014, dhe është marrë në ri-pyetje nga ana e avokatit.

Në raportin e tij të datës 17 Dhjetor 2013, Z. B ka analizuar incizimet e zërit të bëra nga ana e policisë gjatë përgjimit të numrave telefonik xxx, xxx, xxx, xxx, xxx, xxx dhe xxx, dhe i ka krahasuar këto me një mostër të zërit të marrë tek i pandehuri.

Duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 3.352.335, që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri nga të cilët Prokuroria pohon se ishte i Pandehuri duke përdorur numrin e telefonit xxx, dhe duke krahasuar këtë me mostrën e zërit të të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta”²¹ të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe të zërit të të pandehurit.

Duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 3.353.964/651, që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri prej të cilëve, Prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin telefonik xxx, dhe duke krahasuar atë me mostrën e zërit të të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta/vogla”²² të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe zërit të të pandehurit.

¹⁹ Urdhri i Gjykatës për përgjime –Gjermani, Dosja III, Ndarja 23

²⁰ Procesverbali i datës 8 Janar 2014

²¹ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

²² Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

Megjithatë, duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 3.353.972/406/614/827/073, që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri prej të cilëve, Prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin telefonik xxx, dhe duke e krahasuar atë me mostrën e zërit të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta”²³ të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe zërit të të pandehurit.

Duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 3.353.982, që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri prej të cilëve, Prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin telefonik xxx, dhe duke e krahasuar atë me mostrën e zërit të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta”²⁴ të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe zërit të të pandehurit.

Duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 3.356.583, 3.516.912 dhe 3.357.004, që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri prej të cilëve, Prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin telefonik xxx, dhe duke e krahasuar atë me mostrën e zërit të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta”²⁵ të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe zërit të të pandehurit.

Duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 3.575.169 dhe 3.600.227 që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri prej të cilëve, Prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin telefonik xxx, dhe duke e krahasuar atë me mostrën e zërit të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta”²⁶ të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe zërit të të pandehurit.

Duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 4.384.359 dhe 4.394.141 që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri prej të cilëve, Prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin telefonik xxx, dhe duke e krahasuar atë me mostrën e zërit të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta/të vogla”²⁷ të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe zërit të të pandehurit.

Duke iu referuar provës së përgjimit me referencë ID 4.369.763 që përmban një inçizim të një bisede telefonike ndërmjet dy personave, ku njëri prej të cilëve, Prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin telefonik xxx, dhe duke e krahasuar atë me mostrën e zërit të pandehurit, Z. B konstatoi se ka “gjasa të larta”²⁸ të përputhjes ndërmjet zërit të përgjuar gjatë kësaj bisede telefonike dhe zërit të të pandehurit.

Eksperti i forenzikës konstatoi “gjasa të larta/vogla” të përputhjes, kur ka krahasuar mostrën e zërit të të pandehurit me provat e përgjimit të numrave telefonik xxx dhe xxx, ku Prokuroria ka pohuar se ato kanë qenë në posedim dhe përdorim të të pandehurit.

²³ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

²⁴ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

²⁵ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

²⁶ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

²⁷ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 dhe 8 (versioni Anglisht)

²⁸ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 dhe 8 (versioni Anglisht)

Trupi Gjykses, për arsyet e cekura këtu, konstaton se gjatë gjithë kohës në fjalë, i Pandehuri ka qenë në posedim dhe përdorim të numrave telefonik xxx, xxx, xxx, xxx, xxx, xxx, xxx dhe xxx²⁹.

Më tej, për arsyet e cekura këtu, Trupi Gjykses konstaton se gjatë gjithë kohës në fjalë

- i. M.K. ka qenë në posedim dhe në përdorim të numrave celular telefonik xxx³⁰ dhe xxx.³¹
- ii. L.Z. ishte në posedim dhe përdorim të numrit telefonik celular xxx;
- iii. O.B., ka qenë në posedim dhe përdorim të numrave telefonik celular, xxx dhe xxx.³² Sipas Prokurorisë, O.B. gjithashtu ka qenë në posedim dhe përdorim të numrave telefonik xxx, xxx, xxx dhe xxx, por Trupi Gjykses nuk mund të gjente ndonjë lidhje bindëse ndërmjet O.B. dhe numrave të cekur;
- iv. Y.G. ka qenë në posedim dhe përdorim të numrit telefonik celular xxx³³;
- v. Sipas Prokurorisë, R.A. ka qenë në posedim dhe përdorim të numrit telefonik celular xxx. Megjithatë, Trupi Gjykses nuk mund të gjente ndonjë lidhje bindëse ndërmjet R. A. dhe këtij numri;
- vi. A.V. ka qenë në posedim dhe përdorim të numrit telefonik celular xxx³⁴;
- vii. T.V. ka qenë në posedim dhe përdorim të numrit telefonik celular xxx. Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, i Pandehuri konfirmoi se ky ishte numri që përdorej nga babai i tij³⁵;
- viii. D.K. ka qenë në posedim dhe përdorim të numrit telefonik celular xxx³⁶;
- ix. F.F. ka qenë në posedim dhe përdorim të numrit telefonik celular xxx

Më tej, i Pandehuri dëshmoi se M.A. është gruaja e tij e “dytë” (që bashkëjeton), dhe se gjatë vitit 2012, ajo ka jetuar me të. Për më tepër, ai theksoi se Sh.A. është motra e M.A. dhe se B.A. është babai i tyre³⁷.

i. Akuzat 1 dhe 3

Këto Akuza janë ngritur si rezultat i një hetimi që përfshin të pandehurin L (L) G, D.K., O.B., G.Y. dhe M.K., duke arritur pikën kulmore më 20 Shkurt 2012, ku janë kapur pako që kishin tre sasi të ndryshme pluhuri, që peshonin respektivisht 498.7 g, 499.9 g dhe 498.1 g, të cilat më vonë janë konstatuar nga analizat të përmbajnë heroinë. Një qese plastike e vogël ishte zbuluar

²⁹ Raporti i datës 17 Dhjetor 2013

³⁰ M.K. ishte abonenti i regjistruar

³¹ Abonentja e numrit telefonik xxx ka qenë A.V., e motra e të pandehurit. Kartela e këtij numri është gjetur në auto-mjetin Toyota, të cilin ishte duke e ngarë M.K., partneri i A.V.t, në kohën e arrestimit të tij.

³² Kartela SIM, e sekuistruar më 10 Qershor 2012, në posedim të O.B.

³³ Kartela SIM me këtë numër është konfiskuar nga policia gjatë një bastisje më 9 Maj 2012, në apartamentin ku banonte G.Y.

³⁴ Shënim i Detajeve Telefonike të Abonentëve A.V. dhe T.V., Dosja III, Ndarja 22

³⁵ Procesverbali i datës 8 Janar 2014

³⁶ Kartela SIM me këtë numër është sekuistruar nga Policia gjatë bastisjes së apartamentit ku banonte D.K.

³⁷ Procesverbali i datës 8 Janar 2014.

që përmbante një sasi pluhuri prej 2.86 g. Që të tre pakot iu nënshtruan analizave laboratorike dhe është konstatuar se ato përmbanin sasinë totale prej 1496.7g pluhur të shtypur. Sasia e heroinës brenda pluhurit përbënte 11 për qind. U konstatua se qesja plastike prej 2.86 g pluhur përmbante 8 për qind heroinë.³⁸

a. Komunikimet telefonike

Më 17 Shkurt 2012

Në orën 17:46:15³⁹, M.K. (xxx) dërgoi një SMS tek i Pandehuri (xxx), ku ai tha

“Çfarë po bëni? Ndonjë gjë e re nga ana e juaj?”

Në orën 18:11:09⁴⁰, i Pandehuri (xxx) dërgoi një SMS tek M.K. (xxx), ku ai tha:

“Në fakt asgjë....a mos gjete ndonjë person për të më dërguar ato para”.

Në orën 18:11:54⁴¹, M.K. (xxx) dërgoi një SMS tek i Pandehuri (xxx) ku ai tha:

“Jam tek M.S., faktikisht akoma jo. Kur të vijë dikush, unë do të të dërgoj. A ke dërguar ndonjë gjë nga ai?”⁴²

Sipas Prokurorisë, ky diskutim kishte të bënte me shkëmbimin e të hollave që kishin lidhje me marrëveshjen për drogën.

Më 18 Shkurt 2012

Në orën 20:21:01⁴³, i Pandehuri (xxx) zhvilloi një bisedë me M.K. (xxx), gjatë së cilës i Pandehuri udhëzoi M.K. që të shkonte të nesërmen në Aubing, dhe të merrte disa “gjëra”, dhe pastaj t’i çonte në Karlsfed. I pandehuri i tregoi M.K. se ai do të merrte për vete⁴⁴ 300 Euro nga një burrë i moshës së re, dhe 2,000 Euro të tjera, të cilat ishin të destinuara për të Pandehurin. I Pandehuri i tregon M.K. që të merrte parat nga ky person dhe t’i jepte atij “gjërat”.

I Pandehuri udhëzoi M.K. që të udhëtonte vetëm me makinë. I Pandehuri i jep atij adresën se ku do të shkonte, duke thënë “Aubing, Schmanstrasse”. I Pandehuri, më tej, udhëzoi M.K. se “deri në Aubin, do të takohesh me një shok. Ai do të të jap gjërat, ju do të merrni gjërat dhe do të

³⁸ Ekspertiza, Departamenti për Substancat Narkotike, më 21 Gusht 2012, Dosja II, faqet 250-260

³⁹ Dosja III, faqet 193-194

⁴⁰ Dosja III, faqja 195

⁴¹ Dosja III, faqja

⁴² Dosja III, faqet 195-196

⁴³ Dosja III, faqet 200-2004

⁴⁴ ‘fur dich’ për ju

shkoni tek ai/ajo në Karlfeld. Do të të jap gjërat, ai do të të jap atë që i kam thënë, a më kupton?”

Sipas Prokurorisë, interpretimi i vetëm i mundshëm e këtij shkëmbimi është ajo që do të bëhej një shkëmbim i narkotikëve për para me një korrier, i organizuar nga i Pandehuri.

Më 19 Shkurt 2012

Në orën 12:33:28, i Pandehuri (xxx) dërgoi një SMS në numrin xxx, ku ai tha:

“Më thirr”

Në orën 14:41:28⁴⁵, i Pandehuri (xxx) dërgoi një SMS tek numri xxx, ku ai tha:

“Ky është numri im i ri, në rregull, ai nuk ka ardhë akoma”

Në orën 14:42:11⁴⁶, i Pandehuri (xxx) dërgoi një SMS M.K.t (xxx), ku ai thotë:

“Ky është numri im i ri”

Në orën 14:43:23, i Pandehuri (xxx) dërgoi një SMS M.K.t (xxx), ku ai thotë:

“Ai nuk më ka thirrë akoma. Po pres. Do t’ju informoj pastaj”.⁴⁷

Në orën 17:30:58⁴⁸, një person i panjohur (xxx) foli me të Pandehurin në numrin (xxx), gjatë së cilës i Pandehuri thotë *“Idioti erdhi me vonesë”*, dhe se marrëveshja duhej që të shtyhej deri në ditën vijuese. I Pandehuri shpjegoi se ai kishte ndërruar numrin e tij të telefonit. O.B. kërkoi që të lajmërohej dhjetë minuta më përpara, për të cilën i Pandehuri iu përgjigj se O.B. duhet që të mbajë telefonin e ndezur që nga ora 12 e tutje.

Në orën 17:36:21⁴⁹, i Pandehuri (xxx) kontaktoi M.K. në numrin (xxx), dhe i tregoi atij që të jetë gati ndërmjet orës 12:00 dhe 13:00, dhe se do t’i tregonte atij ku të shkonte.

Sipas Prokurorisë, këto mesazhe dhe biseda tregojnë se i Pandehuri kishte për qëllim të dërgonte një korrier për t’u takuar me O.B. dhe M.K. më 19 Shkurt 2013, por ky takim, për shkak të një vështirësie, duhej që të shtyhej për 24 orë.

Në orën 17:43:18⁵⁰, Y.G. (xxx) thirri të Pandehurin (xxx). Gjatë bisedës, i Pandehuri i tregoi Y.G. se ai do të merrte atë në telefon të nesërmen, dhe se pasdite ai duhej *“të shkonte dhe të merrte atë shpejtë”*.

Sipas Prokurorisë, ky komunikim kishte të bënte me dërgesën e narkotikëve.

⁴⁵ Dosja III, faqja 212

⁴⁶ Dosja III, faqja 213

⁴⁷ Dosja III, faqet 213-214

⁴⁸ Dosja III, faqet 215-218

⁴⁹ Dosja III, faqet 218-220

⁵⁰ Dosja III, faqet 220-227

Më 20 Shkurt 2012

Në orën 13:28:03⁵¹, M.K. (xxx), telefonoi të Pandehurin (xxx), dhe ato u pajtuan që M.K. do të ishte në adresën “numër 2” rreth orës katër.

Në orën 13:43:12⁵², M.K. (xxx) kontaktoi A.V. në numrin (xxx) dhe i tregon asaj që “ai” sapo kishte kontaktuar atë dhe se ai do të merrte makinën, dhe pas kësaj, ato do të takoheshin.

Në orën 14:12:12⁵³ i Pandehuri (xxx) kontaktoi M.K. në numrin (xxx), dhe i tregon atij se “ai po të pret atje...kur të shkosh tek ai djali, ai do të të jap këto gjëra dhe një numër telefoni”. I Pandehuri i tregon M.K. që “pastaj atë numër, kur të shkosh atje, do t’ia japësh atij, një djalit tjetër”.

Në orën 14:21:44⁵⁴ i Pandehuri (xxx) kontaktoi M.K.n në numrin (xxx), dhe e pyet atë nëse e njeh “L. e Prizrenit”⁵⁵, M.K. iu përgjigj se ai e njeh atë përmes Y.⁵⁶. I Pandehuri përgjigjet duke i thënë “është keq, dreqi ta hajë, ai s’duhet të të shoh, si ta bëjmë këtë?”.

Sipas Prokurorisë, i Pandehuri nuk donte që korrierët dhe shitësit e tij të njihnin njëri-tjetrin. Qartazi, i Pandehuri nuk donte që vetë M.K. të merrte narkotikët nga korrieri L.G., të cilin e njihnte.

Në orën 14:24:27⁵⁷, M.K. (xxx) kontaktoi A.V.n në numrin (xxx) dhe i tregon asaj për bisedën që ai kishte me të Pandehurin, dhe për faktin se i Pandehuri nuk donte që ai të shkonte dhe të takohej me L.G., sepse ai e kishte takuar atë më parë.

Në orën 14:27:40⁵⁸, M.K. (xxx) kontaktoi me D.K. në numrin (xxx), dhe i thotë atij “a ke bezdi me ardhë diku me mua...më duhet të shkoj në Pasing për të marrë diçka... pikërisht tani...ne do të të japim diçka...hajde që tani...se do të të jap diçka”.

Sipas Prokurorisë, M.K. kishte gjetur një zëvendësim të shpejtë për të asistuar me marrjen e narkotikëve.

Në orën 14:28:52⁵⁹, i Pandehuri (xxx) kontaktoi një person të panjohur (xxx), dhe i tregon atij se “në orën katër, një shok i imi do të shkoj atje...do t’i jap atij numrin tuaj, pastaj ai do të të telefonoj”.

Sipas Prokurorisë, ky ‘shok’ ishte M.K..

⁵¹ Dosja III, faqet 231-233

⁵² Dosja III, faqet 233-234

⁵³ Dosja III, faqet 234-236

⁵⁴ Dosja III, faqet 236-238

⁵⁵ Sipas Prokurorisë, ai është L.G.

⁵⁶ Sipas Prokurorisë, ai është Y.J.

⁵⁷ Dosja III, faqet 238-240

⁵⁸ Dosja III, faqet 242-244

⁵⁹ Dosja III, faqet 244-246

Në orën 14:29:54⁶⁰, i Pandehuri (xxx) kontaktoi M.K. në numrin (xxx). Gjatë kësaj bisede, M.K. i tregon të pandehurit se ai kishte gjetur një person tjetër. I Pandehuri i tregon atij se *“ai nuk duhet që të të takoj, nuk duhet, ky është një shok i juaj!”*

I Pandehuri i tregon M.K. *“shko atje tek ajo adresë që të dhashë me SCH, a e din?”*, dhe të zbresësh atë afër S., atje, dhe prit aty afër makinës. Ai pastaj do ta merrte atë dhe ta dërgonte tek Karlsfeld. Për këtë, M.K. do t’i jepte atij 100 Euro. M.K. i tregon të Pandehurit se 50 Euro janë të mjaftueshme sepse “ai” është nipi i tij. I Pandehuri i tregon atij se një Shqiptar do t’i jepte atij 3000 Euro, prej të cilave, ai duhej që t’i jepte atij 50 Euro, dhe të mbante 250 Euro për vete. M.K., gjithashtu i tregohet që të marr 2000 Euro, të cilat ishin për t’iu dhënë të Pandehurit. I Pandehuri i tregon atij që të linte një pjesë të kësaj tek “numri 2”.

Sipas Prokurorisë, ajo pjesë e dërgesës së heroinës ishte për tu marrë dhe dorëzuar tek O.B. në Karlsfeld.

Në orën 14:48:54⁶¹, M.K. (xxx) kontaktoi me D.K. në numrin (xxx), dhe vendosën për tu takuar.

Në orën 14:53:17⁶², G.Y. ((xxx) dërgoi një SMS tek i Pandehuri (xxx), ku ai thotë

“Sa më shumë kohë?! burracak...”

Në orën 14:54:37⁶³, i Pandehuri (xxx) dërgoi një SMS tek G.Y. (xxx) ku ai thotë:

“rreth orës 6 tek xxx. Do të të telefonoj rreth orës 5”.

Në orën 15:36:53⁶⁴, i Pandehuri (xxx) kontakton M.K. (xxx), dhe i pyet atë nëse e kishte dërguar atë. M.K. iu përgjigj se ato nuk mund të gjenin rrugën. I Pandehuri iu përgjigj duke thënë “xxx

Në orën 15:54:52⁶⁵, i Pandehuri (xxx) kontakton M.K. (xxx). M.K. i tregon atij se *“jam këtu”*. I Pandehuri iu përgjigj, duke thënë *“Në rregull kushëri, që tani do të telefonoj atë djalin dhe ta njoftoj, tani në sekondë, do të dal jashtë”*.

Në orën 15:57:20⁶⁶, D.K. (xxx) kontaktoi M.K. në numrin (xxx) dhe tha *“ej, hajde dhe më merr aty ku më ke lënë”*.

Në orën 15:59:14⁶⁷, i Pandehuri (xxx)⁶⁸ kontaktoi M.K. në numrin (xxx)⁶⁹, dhe e pyeti atë *“a ke mbaruar?”*, M.K. iu përgjigj *“po”*.

⁶⁰ Dosja III, faqet 247-250

⁶¹ Dosja III, faqet 251-252

⁶² Dosja III, faqet 252-253

⁶³ Dosja III, f. 253

⁶⁴ Dosja III, faqet 256-258

⁶⁵ Dosja III, faqet 261-262

⁶⁶ ID 3.355.878, Dosja III, faqet 262-263

⁶⁷ Dosja III, faqet 263-264

⁶⁸ “gjasa të larta” për përputhje zëri, Raporti i datës 17 Dhjetor 2013 (Versioni Anglisht)

⁶⁹ M.K. është abonenti i regjistruar

Sipas Prokurorisë, qëllimi i kësaj bisede ishte për të kontrolluar që gjithçka kishte shkuar sipas planit.

Në orën 15:59:14, i Pandehuri (xxx) kontaktoi M.K. në numrin (xxx), dhe i tregon atij *“Tani shko tek ai në Karls”*⁷⁰

Në orën 16:05, M.K. dhe D.K. janë arrestuar në xxx, Munih⁷¹, me një makinë Toyota Corolla, me numër targe XXX.

Si rezultat i bastisjes së kryer të kësaj makinës, policia sekuestroi pakot që përmbanin tre sasi të ndryshme pluhuri që peshonin respektivisht 498.7 g, 499.9 g dhe 498.1 g. Më tej, një qese e vogël plastike me pluhur me peshë 2.86 g, është gjetur gjithashtu. Të tre pakot iu nënshtruan analizave laboratorike, dhe u konstatua që të përmbanin një total prej 1496.7 g pluhur të shtypur. Sasia e heroinës brenda në pluhur ishte 11 për qind. U konstatua se në qesen plastike prej 2.86 g pluhur kishte 8 për qind heroin.⁷²

Në orën 16:24, L.G. është arrestuar në xxx Munih⁷³

Në orën 16:06:57, i Pandehuri (xxx) telefonoi disa herë⁷⁴ M.K. (xxx).

Sipas Prokurorisë, duke mos qenë në gjendje për të kontaktuar M.K., të pandehurin e kapi paniku.

Në orën 16:38:30⁷⁵, i Pandehuri (xxx) ka folur me një person të panjohur (xxx)

“Unë mendoj, mendoj se e kanë kapur atë...është faji im sepse ai nuk ka të bëjë asgjë me këtë. Ai më thirri mua në atë kohë dhe tha “jemi të mbaruar”. Tani për momentin, telefonave po u bie zilja, por nuk ka përgjigje. Unë nuk e di...ta hajë dreqi, jam në një pozitë të keqe”...ta hajë dreqi, nëse familjarët e marrin vesh këtë që unë e kam dërguar atë, katastrofë, katastrofë!”

Sipas Prokurorisë, gjatë kësaj bisede, i pandehuri ishte duke iu referuar partnerit të motrës së tij, M.K., kur ai thotë *“Mendoj se e kapën atë”*. I pandehuri me siguri ishte i brengosur për reagimin e familjes së tij, kur ato të zbulonin që M.K. ishte arrestuar. Pas kësaj, i pandehuri ka kontaktuar pjesëtarë të tjerë të grupit kriminal për të mbuluar gjurmët e tyre.

Në orën 17:23:35⁷⁶, i Pandehuri (xxx) ka folur me një person të panjohur në numrin (xxx), dhe i tregon atij *“hiqe kartelën, hiqe baterinë, hidhe kartelën sepse mendoj se ai e ka shkruar timin, hidhe, në rregull?”*

Në orën 17:29:42⁷⁷, i Pandehuri (xxx) dërgoi një SMS tek G.Y. (xxx), ku ai thotë

⁷⁰ Trupi Gjykes konstaton se këtu i referohet Karlsfeld, një qytet në Republikën Federale të Gjermanisë.

⁷¹ Procesverbali në dosje, M.K., Dosja III, faqet 87-88, 105-106

⁷² Ekspertiza, Departamenti i Substancave Narkotike, më 21 Gusht 2012, Dosja III, faqet 250-260.

⁷³ Përmbledhje/Vështrim, Dosje II, faqet 29, 47

⁷⁴ Dosja II, faqet 266 - 271

⁷⁵ Dosja II, faqet 272-274, 274-277

⁷⁶ Dosja II, faqet 278-279

⁷⁷ Dosja II, faqja 280

“Ai nuk është gjallë. Do t’ju lajmëroj më vonë”.

Motra e të pandehurit gjithashtu është përpjekur për të kontaktuar partnerin e saj, M.K..

Në orën 17:47:51⁷⁸, A.V. (xxx) i dërgon një SMS M.K. (xxx), ku ajo thotë:

“M. më merr në telefon! Ku je?”

Gjithashtu, babai i të pandehurit ka kontaktuar të pandehurin.

Në orën 18:57:40⁷⁹, T.V. (xxx) kontaktoi të Pandehurin (xxx) dhe e pyet atë *“Ku je, A.?. I Pandehuri i tha “...ai dërgoi një nga shokët e tij, ai qëndroi me të atje, ai dështoi”.* T.V. tha *“në rregull, fol me A. sepse unë nuk kam kohë”.*

Gjatë kësaj bisede, babai i të pandehurit i referohet të pandehurit duke përdorur emrin e tij, “A”. Gjithashtu, babai i të pandehurit i referohet në emër motrës së të pandehurit, “A”.

A.V. pastaj merr telefonin prej T.V. dhe flet me të Pandehurin. I Pandehuri e pyet A.V. për ‘B’. A.V. i thotë se emri i tij është “D.”.

Sipas Prokurorisë, kjo bisedë ka ndërlidhur të pandehurin me telefonin që ai e ka përdorur për të kontaktuar D.K, i cili kishte shoqëruar M.K. me makinën Toyota Corolla, kur ato shkuan për t’u takuar me L.G., kur është dorëzuar droga.

Në orën 20:12:05⁸⁰, Y.G. (xxx) ka folur me të Pandehurin (xxx) dhe e pyet atë *“Çfarë po ndodh”.* I Pandehuri iu përgjigj duke thënë se ai do ta telefononte atë të nesërmen.

Në orën 20:13:01⁸¹, Y.G. (xxx) kontaktoi një person të panjohur (xxx) dhe tha:

“djali është vrarë”

Sipas Prokurorisë, ky komunikim është tregues i faktit që një pjesë e heroinës së kapur, ishte e destinuar për tu dërguar tek Y.G., dhe kjo ishte arsyeja se pse i Pandehuri e ka kontaktuar atë kaq shpejt, dhe pse Y.G. po jepte informacione tek një bashkë kryerës i panjohur duke i thënë se korrieri ishte kapur.

Në orën 23:31:43, një person i panjohur (xxx) flet me të Pandehurin (xxx). Gjatë kësaj bisede i Pandehuri i tregon atij *“ato kanë lëvizur...ta hajë dreqi...ble një numër të ri dhe nesër ma dërgo, dhe unë do të telefonoj nga Posta...”*

Sipas Prokurorisë, ajo pjesë e kapur e heroinës së dërguar ishte e destinuar për O.B.n. Në atë mbrëmje, një numër telefonatash dhe SMS janë shkëmbyer ndërmjet atij dhe të pandehurit (xxx) gjatë së cilës, i Pandehuri i tregon O.B.t që të *“blinte një numër të ri”*⁸².

⁷⁸ Dosja III, faqet 281-282

⁷⁹ Dosja xx, faqet 286-289

⁸⁰ Dosja III, faqet 289-290

⁸¹ 3.356.750, Dosja III, faqet 290-292

⁸² 3.357.004, Dosja III, faqet 292-293

Më 21 Shkurt 2012

Në orën 12:41:54⁸³, një person i panjohur (xxx) kontaktoi të Pandehurin (xxx) dhe tha:

“se avokati nuk mund të bëjë ndonjë gjë, nuk ka asgjë për momentin derisa ato të shkojnë atje.”

Sipas Prokurorisë, ato po diskutonin arrestin e D.K. dhe M.K., dhe të qasjes së tij me një avokat, ndërkohë që është në ndalim policor pas arrestit të tij.

b. Bastisjet dhe Arrestet

1. Kontrolli i auto-mjetit Toyota Corolla me numër targe xxx

Pas arrestimit të D.K. dhe M.K. në orën 16:05, më 20 Shkurt 2012, policia kontrolloi auto-mjetin Toyota Corolla me numër targe xxx, në të cilin ishin M.K. dhe D.K..

Libreza e makinës u gjet në një xhep, prapa mbrojtëses së diellit të makinës, ku tregohet se makina ishte e regjistruar në emër të S.V. nga xxx, M.S.⁸⁴. S.V. është nëna e të pandehurit.⁸⁵

Brenda makinës në fjalë, prapa ulëses së shoferit, policia sekuestroi një qese plastike të Lidl, e cila kishte një kuti. Brenda asaj kutie kishte tre pako të kuqe, të cilat përmbanin tre sasi të ndryshme pluhuri që peshonin respektivisht 498.7 g, 499.9 g dhe 498.1 g. Gjithashtu, një qese tjetër e vogël plastike u zbulua, e cila përmbante 2.86 g pluhur.⁸⁶

Të tre qeset që përmbanin respektivisht 498.7 g, 499.9 g dhe 498.1 g⁸⁷ pluhur të shtypur, janë analizuar dhe u konstatua që ato përmbanin heroin. Sasia e heroinës në pluhur ishte 11 për qind. U konstatua që qesja plastike që përmbante 2.86 g pluhur përmbante 8 për qind heroin.⁸⁸

Një patentë shoferi dhe një pasaportë Jugosllave u gjetën në makinë, të cilat mbanin emrin e A.V., motrës së të pandehurit.

Dy telefona celular u gjetën brenda makinës⁸⁹.

Njëri telefon ishte një I-phone⁹⁰. Ky I-phone, më vonë, iu nënshtrua analizave dhe u zbulua të ketë numrin IMEI xxx, dhe kartelën SIM të Vodafone, me numër xxx. Abonent i atij numri ishte A.V..

⁸³ 3.357.743, Dosja III, faqet 297-298

⁸⁴ Shënimet në Shkresat e Lëndës së K., të datës 20.02.2012, Dosja II, faqet 87-88, 105-106

⁸⁵ Shënimet në Shkresat e Lëndës së K., të datës 20.02.2012, Dosja II, faqet 87-88, 105-106

⁸⁶ Albumi Fotografik i Makinës dhe i Narkotikëve të datës 21.02.2012, Dosja II, faqet 53-86

⁸⁷ Sasia totale, 1496.7 g

⁸⁸ Ekspertiza, Departamenti i Substancave Narkotike, më 21.08.2012, Dosja II, faqet 250-260.

⁸⁹ Vlerësimi i Provave M.K. të datës 16.08.2012, Dosja II, faqet 123-157

⁹⁰ Ibid, faqet 125-129, 142-146, Prova 'Ass 02'

Numrat e telefonit të gjetur në listën e kontakteve të Iphon-it në fjalë dhe kartela SIM, ndërlidh përdoruesin e këtij telefoni celular dhe kartelën SIM me të Pandehurin:

- i. Sendi 51, i regjistruar nën ‘numri i tij’ ishte xxx; ky ishte një numër telefoni i përdorur nga M.K., që i Pandehuri dhe D.K. e kanë përdorur për të kontaktuar atë para shkëmbimit të drogës, dhe në të cilin A.V. ka dërguar një SMS M.K., pasi që ai arrestohet;
- ii. Sendi 65, i regjistruar nën ‘A H T1’ ishte xxx; ky është numri i telefonit të T.V., babai i të Pandehurit⁹¹. T.V. ka përdorur këtë numër për të thirrur të Pandehurin (xxx)⁹², pas arrestimit të M.K. në orën 18:57:40, më 20 Shkurt 2012 dhe gjatë së cilës, ai iu referua në emër ‘A.’;
- iii. Sendi 93, i regjistruar nën ‘V.B. Handy’, numri xxx; Ky është numri që T.V. ka thirrur për të folur me të Pandehurin (shiko më sipër pikën (ii)); Eksperti i caktuar nga Gjykata gjeti “gjasa të larta” të përputhjes me zërin e të pandehurit, gjatë analizimit të incizimit të përgjimit të telefonit me personin që ka përdorur këtë numër⁹³.
- iv. Sendi 96, i regjistruar nën ‘H.Th.’, numri xxx; i Pandehuri e ka përdorur këtë numër telefoni për të kontaktuar M.K.n më 18 Shkurt 2012, dhe O.B.n më 19 Shkurt 2012. Ky numër gjithashtu u gjet i regjistruar në telefonin e dytë që u zbulua në makinën Toyota Corolla. Eksperti i caktuar nga Gjykata gjeti “gjasa të larta” përputhjeje me zërin e të pandehurit, kur analizoi incizimin e përgjimit telefonik me personin që ka përdorur këtë numër⁹⁴.
- v. Sendi 125, i regjistruar nën ‘Th.’, numri xxx; ky është numri që Y.G. ka përdorur për të kontaktuar të Pandehurin. Ky numër, gjithashtu ishte i regjistruar në telefonin e dytë të zbuluar në makinë. Eksperti i caktuar nga Gjykata gjeti “gjasa të larta” përputhjeje me zërin e të pandehurit, kur analizoi incizimin e përgjimit telefonik me personi që ka përdorur këtë numër⁹⁵.

Telefoni i dytë i sekuestruar ishte një Nokia 1800⁹⁶, i cili mbante numrin IMEI xxx, dhe një kartelë SIM O2 me numër xxx.

Numrat e telefonit të ruajtura në listën e kontakteve në telefonin e cekur, Nokia 1800, dhe kartela SIM, ndërlidh përdoruesin e këtij telefoni celular dhe kartelën SIM me të Pandehurin:

⁹¹ Detajet Telefonike të Abonentit T.V.t, Dosja III, Ndarja 22

⁹² “Gjasa të larta” përputhje të zërit, Raport i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

⁹³ Raport i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

⁹⁴ Raport i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

⁹⁵ Raport i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

⁹⁶ Ibid, faqet 129-133, 146-150, Prova ‘Ass 03’

- i. Sendi 21, ky regjistron numrin e vetë të telefonit nën ‘xxx’. Paketimi dhe dokumentet e kontratës për këtë aparat janë gjetur në apartamentin ku banonte M.K. (shiko më poshtë). Ky ishte numri kryesor që M.K. ka përdorur për të kontaktuar të Pandehurin;
- ii. Sendi 2, i regjistruar nën ‘Ar Ks’, ishte numri i telefonit xxx. Ky është i njëjti numër që është gjetur në Iphon-*in* e lartpërmendur të shënuar nën sendin 96, ‘H Th’. Eksperti i caktuar nga Gjykata gjeti “gjasa të larta” përputhjeje me zërin e të pandehurit, kur analizoi inçizimin e përgjimit telefonik me personin që ka përdorur këtë numër⁹⁷.
- iii. Sendi 6, i regjistruar nën ‘Been Ks Ks’ është numri i telefonit xxx. Eksperti i caktuar nga Gjykata gjeti “gjasa të larta” përputhjeje me zërin e të pandehurit, kur analizoi inçizimin e përgjimit telefonik me personin që ka përdorur këtë numër⁹⁸. Ky është numri që i Pandehuri ka përdorur më shpesh, jo vetëm për të kontaktuar M.K., por edhe për të kontaktuar O.B.n. Në orën 14:41 dhe 14:42, më 19 Shkurt 2012, i Pandehuri lajmëroi që të dy burrat për numrin e tij të ri.
- iv. Sendi 22, i regjistruar nën ‘Th.’, numri xxx. Ky emër i njëjte dhe numër telefoni janë të regjistruar nën sendin 125 tek *Iphon-i* i lartpërmendur. Eksperti i caktuar nga Gjykata gjeti “gjasa të larta” përputhjeje me zërin e të pandehurit, kur analizoi inçizimin e përgjimit telefonik me personin që ka përdorur këtë numër⁹⁹.

2. Bastisja e Banesës së M.K. dhe A.V.

Më 20 shkurt 2012 mes orës 17:25 dhe 18:45, policia e ka kontrolluar banesën e M.K. dhe A.V. në adresën xxx në Munih, Gjermani¹⁰⁰.

Është mbajtur një procesverbal i kontrollit në të cilin janë shënuar sende të ndryshme me vlerë provuese¹⁰¹. Prova W1 ka qenë paketimi O2 dhe dokumentet kontraktore për telefonin mobil Nokia 1800 me ngjyrë argjendi të hirtë, me IMEI numër xxx. Ky ka qenë numri i IMEI i aparatit të sekuestruar gjatë kontrollit të mjetit motorik Toyota Corrolla. Numri i telefonit mobil me parapagim ka qenë xxx. Dokumentacioni i llogarisë ka treguar se ai ka qenë në emër të “M. K.” nga Munihu, xxx.

Prova W4 ka qenë dokument që dëshmon pagesën e lëshuar nga Western Union më datë 9 shkurt 2012 në shumë prej 326 euro dhe aty thuhet se i pandehuri ka qenë pranuesi i parave.

⁹⁷ Raport i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

⁹⁸ Raport i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

⁹⁹ Raport i datës 17 Dhjetor 2013, faqja 7 (versioni Anglisht)

¹⁰⁰ Shënimet për dosje nga kontrolli i shtëpisë, Munih, xxx datë 28.02.2012, Dosja II, f. 87-122

¹⁰¹ Raporti vlerësues i sendeve të sekuestruara nga banesa e M.K., i datës 28.02.2012, Dosja II, f. 94-104, 112-122

1. Arrestimi i G.Y. dhe kontrolli i banesës së tij

Më 9 maj 2012, G.Y. është arrestuar dhe është kontrolluar banesa e tij në adresën xxx, Munich, Gjermani¹⁰². Aty janë gjetur para të gatshme në shumë prej 7,700 euro. Gjithashtu, policia ka sekuestruar pluhur të bardhë.

Gjatë kontrollit, policia ka sekuestruar aparate të telefonave mobil dhe SIM kartela¹⁰³ duke përfshirë një i-phone të bardhë me numër xxx.

- i. Në listën e numrave me numër 139 ka qenë emri 'A' ku janë shënuar dy numra, xxx dhe xxx. Eksperti i caktuar nga gjykata ka konstatuar një "gjasë të madhe" të përputhjes me zërin e të pandehurit kur ka analizuar një incizim të përgjimit telefonik të personit që i ka përdorur këta numra.¹⁰⁴ Numri i telefonit xxx është kontaktuar nga numri i G.Y. siç u cek më lartë pak para këmbimit të narkotikëve.

Këta numra të njëjtë janë ruajtur në dy telefonat mobilë të sekuestruar gjatë kontrollit të mjetit motorik Toyota Corolla. Numri i telefonit xxx është regjistruar në listën e kontakteve të iPhone me emrin 'V.B. H.'. Numri i telefonit xxx është regjistruar në të njëjtin aparat me emrin 'H.Th.'. I pandehuri e ka përdorur këtë numër të telefonit për të kontaktuar me M.K. më 18 shkurt 2012 dhe për të kontaktuar me O.B. më 19 shkurt 2012. Numri i telefonit xxx është regjistruar në listën e kontakteve të aparatit Nokia 1800 me emrin 'Ar Ks'.

- ii. Nën rubrikën 161 ka qenë emri 'A. 2' dhe numri i telefonit xxx. Ky numër ka qenë në kontakt me numrin e G.Y. pak para arrestimit të M.K.. Ky numër është ruajtur në të dy telefonat e marrë nga M.K.¹⁰⁵ ku është i regjistruar me emrin 'Th.' Eksperti i caktuar nga gjykata ka konstatuar "gjasë të madhe" të përputhjes me zërin e të pandehurit me rastin e analizimit të incizimit të përgjimit telefonik nga personi që ka përdorur këtë numër.¹⁰⁶
- iii. Nën rubrikën me numër 186 është emri 'A' dhe numri xxx. Ky numër i telefonit është përdorur më 1 qershor 2012 në orën 10:55 nga M.A., në kohën kur ajo jetonte me të pandehurin në Prishtinë dhe, sipas dëshmisë së tij në intervistë me prokurorin¹⁰⁷, ka jetuar me të që nga kthimi i tij në Kosovë në fund të vitit 2011. Eksperti i caktuar nga gjykata ka konstatuar "gjasë të madhe" të përputhjes me zërin e të pandehurit me rastin e analizimit të incizimit të përgjimit telefonik nga personi që ka përdorur këtë numër.¹⁰⁸

¹⁰² Raporti i kontrollit Y. G. i datës 09.05.2012, Dosja II, f. 211-249

¹⁰³ Po aty., 214-221, 234-241

¹⁰⁴ Raporti i datës 17 dhjetor 2013, faqe 7 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁰⁵ Provat Ass 02 dhe 03

¹⁰⁶ Raporti i datës 17 dhjetor 2013, faqe 7 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁰⁷ Dëshmia në procedurë paraprake e të pandehurit, Dosja V, f. 352

¹⁰⁸ Raporti i datës 17 dhjetor 2013, faqe 7 (versioni në gjuhën angleze)

Disa SIM kartela janë sekuestruar gjatë kontrollit në adresën e G.Y.. Një SIM kartelë me numër të telefonit xxx. Në këtë SIM kartelë janë regjistruar numrat xxx nën emrin 'A' dhe xxx nën emrin 'A'.

Në orën 18:47 më 12 prill 2012 i pandehuri ia ka dërguar G.Y. një sms në të cilin ka thënë:

“Xxx, duhet të mi dërgosh nesër përmes Western Unionit dy mijë euro pastaj njeriu im do të vjen te ti të dielën. Duhet t'ia japë dy mijë euro përndryshe ata nuk do të largohen dhe unë për momentin nuk kam mjaft para me vete përndryshe nuk do të kishte problem”.

Në orën 18:50 më 12 prill 2012 G.Y. ia ka dërguar një SMS të pandehurit në të cilin ka thënë:

“nëse mund t'i dërgosh nesër më trego në mënyrë që unë t'i përgatisë të gjitha”.

Porositë me SMS që janë gjetur të regjistruara në librin e telefonit tregojnë për kontakte të shpeshta mes G.Y. me numrat që trupi gjykues i ka gjetur t'i ketë përdorur i pandehuri. Këto kontakte kanë filluar menjëherë pasi i pandehuri është larguar nga K. I. A.. I pandehuri dhe G.Y. kanë qenë pacientë në klinikë në të njëjtën kohë.

Përgjatë gjithë komunikimeve të tyre i pandehuri vazhdimisht e ka quajtur G.Y. me nofkën 'xxx.'

I pandehuri është depërtuar nga Gjermania.

Në orën 08.45 më 18 nëntor 2011 i pandehuri ia ka dërguar në sms G.Y.ku i ka thënë:

“Tungjatjeta xxx, jam në Kosovë qe një javë. Tung, A.”.

Ai SMS është dërguar një javë pasi i pandehuri është depërtuar nga Gjermania.

Në orën 11:56 më 19 nëntor 2011 G.Y. ia ka dërguar një sms të pandehurit ku ka thënë:

“e kam numrin tënd, Xxx.”

Pastaj pasojnë një numër porosish me SMS mes këtyre dyve me A.V.n shpesh duke iu referuar Y. me të njëjtin pseudonim.

2. Arrestimi i D.K. dhe kontrolli i banesës së tij

Policia e ka kontrolluar banesën e D.K. në adresën xxx Munih, Gjermani.

Gjatë rrjedhës së kontrollit policia e ka sekuestruar një telefon mobil Nokia 5250 dhe një SIM kartelë me numër të telefonit xxx. Ky numër ka qenë numri i njëjtë të cilin e ka përdorur D.K. për të kontaktuar me M.K..

i. Pikat e akuzës 2 dhe 3

a. Komunikimet telefonike

Këto akuza dalin nga një hetim i cili përfshin të pandehurit F.B., O.B., L.Z. dhe R.A. i cili kulminon me sekuestrimin e datës 10 qershor 2012 të tri pakove me pesha përkatësisht 0.554, 0.546 dhe 0.336 kg.¹⁰⁹ Në ekzaminim¹¹⁰, pesha neto e pluhurit ka qenë 1.293 kg e pluhurit që përmban heroin, paracetamol dhe caffeine. Përbërja e heroinës në pluhur ka qenë 11%.

2- 25 prill 2012

Më 2 prill 2012¹¹¹ në orën 19:57:52 i pandehuri (xxx) ka biseduar me një person të panjohur (xxx)

“na u qi puna, tash duhet me prit deri në javën e ardhshme”.

“...fati ynë i keq, kur me thirrur dje dhe më ka thënë ‘A, dil jashtë diku në rrugë’...”

“...vëllai im po shikon nëse mund të bëjë diçka për nesër ose pasnesër për ta dërguar ata me veturë”.

“Por, e gjej një zgjidhje, mos u brengos. Nëse nuk mund të bëj asgjë të hënën do ta kesh atje, do të bëj diçka.”

Ka qenë argumentim i prokurorisë se gjatë këtij komunikimi i pandehuri i është referuar faktit se korrierët nuk kanë mundur që të arrijnë në Gjermani me autobusë për shkak të një demonstrate në Kosovë. Po ashtu, prokuroria ka pohuar se me “ata” i është referuar drogës.

Gjatë këtij komunikimi i pandehuri i është referuar vetes me emrin “A”.

Më 10 prill 2012¹¹² në orën 12:51:02 një person i panjohur (xxx) ka folur me të pandehurin (xxx)

“askush nuk dëshiron ta dërgojë atë atje...ata po frikësohen. Këta djemtë e mutit po i kontrollojnë se kush po vjen me autobus, për këtë arsye janë të frikësuar. Vërtet nuk po di se kujt t’ia japë, ta hajë djalli, atë e kam këtu”.

Ka qenë argumentim i prokurorisë se kjo bisedë ka pasur të bëjë me vështirësinë e importimit të drogës në Gjermani dhe se i pandehuri ka qenë i nervozuar se korrierët nuk kanë qenë në gjendje që ta transportojnë drogën me autobus për shkak të kontrollimeve të policisë dhe se ai ende a kishte “atë” me të në Kosovë.

Ka qenë argumentim i prokurorisë se me “atë” i është referuar drogës.

¹⁰⁹ Gjithsej nga rreth 1.436 kg

¹¹⁰ Raporti i ekzaminimit të narkotikëve i datës 04.12.2012, Dosja II, f. 312A-312F

¹¹¹ Dosja IV, f. 332-336

¹¹² Dosja IV, f. 336-340

Më 22 prill 2012 në orën 10:59:34¹¹³ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një sms një personi të panjohur (xxx) ku ka thënë:

“Shoku, nesër do ta dërgoj atë me veturë. Sa para i ke me vete tani?”

Më 24 prill 2012 në orën 22:22:00¹¹⁴, O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku ka thënë:

“Më thuaj definitivisht se si do të jetë, nëse do të kryhet, është mirë, nëse jo, unë nuk mund të mbështetem te ti sepse kjo ka marrë shumë kohë.”

Më 25 prill 2012 në orën 09:13:49¹¹⁵ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një sms O.B. (xxx) ku i ka thënë:

“do të mundohem ta dërgoj atë nëse mund ta gjejë ndonjë person që do të niset tani...sepse shumë kohë është bllokuar...shpresoj se rruga do të hapet...”

6 maj – 3 qershor 2012

Mes 6 majit dhe 25 majit 2012 i pandehuri (xxx) ka komunikuar me O.B. (xxx) lidhur me marrjen e parave.

Më 17 maj 2012 në orën 21:01:57¹¹⁶ O.B. (xxx) ia ka dërguar një SMS të pandehurit (xxx) ku ka thënë

“...tani do të punoj diçka dhe gjithashtu do të shikoj këtu. Nëse i bën pesë mijë pasta t’ia japësh ato atij që do të vijë.”

Më 17 maj 2012 në orën 21:07:58¹¹⁷ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku thotë

“Shoku, ka ndodhur diçka këtu dhe ne jemi pa para, unë nuk mund të bëjë asgjë; nëse mund të bësh para do të ishte mirë, sepse gjithçka ndalet këtu”

Më 17 maj 2012 në orën 21:12:14¹¹⁸ O.B. (xxx) ia ka dërguar një SMS të pandehurit (xxx) ku thotë

“Shoku, sa para të duhen, dhe pa praninë e tij këtu unë nuk mund të japë para, ndoshta do t’i marr nga dikush para kohe por pastaj ajo duhet të jetë këtu. A po kupton?”

Më 17 maj 2012 në orën 21:12:32¹¹⁹ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku i thotë

¹¹³ Dosja IV, f. 355-356

¹¹⁴ Dosja IV, f. 358-359

¹¹⁵ Dosja IV, f. 359-60

¹¹⁶ Dosja IV, f. 368

¹¹⁷ Dosja IV, f. 368

¹¹⁸ Dosja IV, f. 370

“Nëse më beson shoku dërgomi 10 mijë LEK ...”

Më 25 maj 12 në orën 22:06:54¹²⁰, O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku i thotë:

“i kam një mijë, asgjë më shumë.”

Më 25 maj 2012 në orën 22:44:29¹²¹, i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku i thotë

“bëj diçka, a mund të japësh kur të arrish atje, sa mund t’i bësh?”

Më 25 maj 2012 në orën 22:46:59¹²² O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku i thotë:

“Kushëri, do t’i japë pesë mijë, vetëm me ditë me siguri se kur do të vijë ai.”

Ka qenë argumentim i prokurorisë se O.B. ofronte vetëm 1,000 € fillimisht e pastaj ka treguar se do t’ia jepte 5,000€ korrierit të drogës pas arritjes së tij në Munih.

Më 26 maj 2012 në orën 10:15:51¹²³ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku i thotë

“..nëse mund t’i bësh gjysmën e parave unë mund ta dërgoj atë po ti duhet t’i japësh paratë menjëherë. A mund t’i bësh dhjetë mijë apo jo, më trego?”

Më 26 maj 2012 në orën 14:12:35¹²⁴ O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku i thotë:

“Nuk mund t’i përgatisë aq shumë por kryeje punën me këto pesë mijë menjëherë dhe për katër ditë, unë do t’i japë të tjerat.”

Më 28 maj 12 në orën 16:36:31¹²⁵ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B.t (xxx) ku i thotë

“Shoku im, nëse mund t’i japësh dhjetë mijë kur personi të vjen atje, unë mund ta dërgojë atë te ti”.

Ka qenë argumentim i prokurorisë se kjo ka qenë një kërkesë e qartë që O.B. t’ia dorëzojë 10,000€ korrierit në këmbim me ‘atë’ (që do të thotë me narkotikët).

Më 29 maj 12 në orën 00:51:56¹²⁶ O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku i thotë:

¹¹⁹ Dosja IV, f. 370

¹²⁰ Dosja IV, f. 464

¹²¹ Dosja IV, f. 465

¹²² Dosja IV, f. 373

¹²³ Dosja IV, f. 467

¹²⁴ Dosja IV, f. 467

¹²⁵ Dosja IV, f.468

¹²⁶ Dosja IV, f.469

“Në rregull shoku, do t’ia japë atij ku të vjen.”

Më 29 maj 2012 në orën 00:53:00¹²⁷ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku i thotë

“Në rregull, atëherë do të përpiqem ta dërgoj ata te ti sa më parë.”

Sërish, ka qenë argumentim i prokurorisë se ‘ata’ ka qenë referencë në drogë.

Më 29 maj 12 në orën 00:57:32¹²⁸ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B.t (xxx) ku i thotë

“...e kam kryer punën me shokun tim dhe pajtohem ta dërgojmë ata te ti nëse i ke paratë. Nesër, do t’i them se ti do t’ia japësh paratë dhe do të mundohemi ta dërgojmë te ti sa më shpejt...do të tregoj se kur do të vjen te ti..”

Më 29 maj 2012 në orën 20:13:42¹²⁹ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku i thotë

“...do ta dërgoj ata te ti në fund të kësaj jave. Për disa ditë do të tregoj saktësisht kur, në rregull?”

Më 30 maj 2012 në orën 01:29:15¹³⁰ O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku i thotë:

“...do të pres.”

Më 31 maj 2012 në orën 10:59:42¹³¹ O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku i thotë:

“...çka ka të re atje në Kosovë? Me siguri po ia kaloni mirë..”

Më 31 maj 2012 në orën 11:57:25¹³² i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B.t (xxx) ku i thotë

“..mos u brengos shuku im. Do ta kryejmë atë punë.”

Më 1 qershor 2012 në orën 10:55¹³³, M.A. (duke përdorur numrin e telefonit xxx) ka biseduar me “Sh.” (xxx).¹³⁴

Mes 6 majit 2012 dhe 4 qershorit 2012¹³⁵, ka pasur kontakte të gjera mes të pandehurit dhe O.B.t.

M.A. është përshkruar nga i pandehuri si gruaja e tij e dytë pa kurorë, “Sh.” është motra e M.A..

¹²⁷ Dosja IV, f. 470

¹²⁸ Dosja IV, f. 470A

¹²⁹ Dosja IV, f. 470A

¹³⁰ Dosja IV, f 472

¹³¹ Dosja IV, f. 473

¹³² Dosja IV, f. 473

¹³³ CD-ja e përgjimeve të drejtpërdrejta

¹³⁴ Numri i regjistruar në emër të B.A., Raporti për Abonentin PTK/IPKO, Dosja V, f. 284-295

¹³⁵ Dosja IV, f. 361-390

4 qershor 2012

Në orën 13:45:55¹³⁶, i pandehuri (xxx) ka kontaktuar me O.B. (xxx) dhe i ka thënë “një shok i imi do të vijë atje të enjten...me veturë...a ke një vend ku ai mund ta parkojë veturën?...një vend për të hyrë...e din...merre një numër të ri të telefonit...thirre atë djalin nga fshati yt, të afërmin tënd...dhe jepja atij...unë e marr numrin prej tij”

Ka qenë argumentim i prokurorisë se i pandehuri dhe O.B. po diskutonin për gjetjen e një garazhi në Munihi në të cilin do të futej vetura që bartë narkotikë dhe do të shpakohej në mënyrë të fshehtë. I pandehuri e ka udhëzuar O.B. për ta marrë një numër të ri të telefonit dhe për t’ia komunikuar atij numrin e ti përmes dikujt nga familja e tij.

6 qershor 2012

Në orën 14:57:27 O.B. (xxx) ka biseduar me të pandehurin (xxx) dhe i ka thënë

“..do ta marr numrin dhe pastaj të thërras”

Në orën 16:31:32¹³⁷ O.B. (xxx) ka biseduar me të pandehurin (xxx) dhe i ka thënë

“...për 20 minuta.” I pandehuri është përgjigjur “...do ta shohësh atëherë”

Në orën 16:58:55¹³⁸ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një sms O.B. (xxx) ku i thotë:

“shoku çka po bën, a je mirë?”

Ky SMS është dërguar rreth 20 minuta pas komunikimit të fundit në orën 16:31 mes O.B. dhe të pandehurit në numrin e (xxx) për të cilin Trupi Gjykses ka konstatuar se ka qenë në posedim dhe shfrytëzim nga i pandehuri. Trupi Gjykses konstaton se SMS-i në orën 16:58:55 ka qenë këmbim i numrave të ri të telefonit mes të pandehurit dhe O.B.t.

Trupi Gjykses konstaton se numri i telefonit mobil xxx ka qenë në posedim dhe shfrytëzim nga O.B..

Në orën 17:40:52¹³⁹ i pandehuri (xxx) ka biseduar me O.B. (xxx) dhe i ka thënë

“...do të donim ta dërgonim atë djalin, por kemi menduar se më mirë është të nisemi të premtën për të arritur atje në fundjavë, më mirë për të arritur të shtunën.

7 qershor 2012

Në orën 12:20:30¹⁴⁰ i pandehuri (xxx) ka biseduar me O.B. (xxx) dhe i ka thënë

¹³⁶ Dosja IV, f. 390-394

¹³⁷ Dosja IV, f. 405-407

¹³⁸ Dosja IV, f. 408

¹³⁹ Dosja IV, f. 410-413

¹⁴⁰ Dosja IV, f. 414-415

“Të thërras më vonë dhe të tregoj ku të dërgohen letrat, sepse ai punon deri në orën pesë dhe pastaj dërgoja atë atij në mbrëmje”

Ka qenë argumentim i prokurorisë se “letrat” ka qenë referencë për paratë dhe se ky komunikim ka pasur të bënte me gjetjen e një personi tjetër të cilit ata do të mund t’ia dërgonin paratë përmes Western Unionit.

Në orën 16:48:46¹⁴¹ i pandehuri (xxx) ka biseduar me O.B. (xxx) dhe i ka thënë

“Shoku, mundohu ta gjesh dikë për t’i dërguar ato në Western Union nesër në mëngjes, sepse ai shoku nuk mundet. A mund ta bësh këtë nesër në mëngjes?”

Në orën 22:49:17¹⁴² i pandehuri (xxx) ka biseduar me O.B. (xxx) dhe i ka thënë

“Shoku, a do ta bësh atë punë nesër në mëngjes, sepse ne jemi gati”

Në orën 22:53:30¹⁴³ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një sms O.B. (xxx) ku i thotë:

“Emri është M.A..”

Ka qenë argument i prokurorisë se ky sms e ka lidhur edhe më shumë të pandehurin me numrin e telefonit xxx. Në atë sms i është referuar M.A., gruas së të pandehurit pa kurorë. Ajo ka qenë pranuesi i transferimit të parave nga Western Union.

8 qershor 2012

Në orën 16:05:06¹⁴⁴ O.B. (xxx) ka kontaktuar me L.Z. (xxx) dhe i ka thënë që t’ia sjellë atij automjetin.

Në orën 16:15:22¹⁴⁵ L.Z. (xxx) ia ka dërguar një sms O.B. (xxx) ku i thotë:

“xxx”

Në orën 16:20:53¹⁴⁶ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një sms O.B. (xxx) ku i thotë:

“Shoku, në orën 17:00 do të mbyllet.”

Ka qenë argument i prokurorisë se këto komunikime i janë referuar transferimit të fondeve përmes Western Unionit. “xxx” ka qenë numri i referencës së Western Unionit. Zyra e Western Unionit do të mbyllet në orën 17:00.

Në orën 16:24:07¹⁴⁷ O.B. (xxx) ka kontaktuar me L.Z. (xxx) dhe e ka pyetur se ku ishte. L.Z. është përgjigjur “*rrugës duke shkuar për ta marrë automjetin*”. O.B. ka kërkuar nga ai “*ma jep vetëm atë numrin*”. L.Z. është përgjigjur “*e kam dërguar me SMS*”.

¹⁴¹ Dosja IV, f. 414-415

¹⁴² Dosja IV, f. 418-419

¹⁴³ Dosja IV, f. 421

¹⁴⁴ Dosja IV, f. 428-430

¹⁴⁵ Dosja IV, f. 430-431

¹⁴⁶ Dosja IV, f. 431

Në orën 16:25:17¹⁴⁸ O.B. (xxx) ia ka dërguar një sms të pandehurit (xxx) ku i thotë:

“xxx L.Z..”

Ka qenë argumentim i prokurorisë se këto komunikime mes të pandehurit, O.B. dhe L.Z. kanë pasur të bënim me faktin se O.B. e kishte dërguar L.Z. në zyrën e Western Unionit me qëllim që ai t’i dërgonte paratë në Kosovë për të pandehurin. Pastaj, O.B. ia ka dërguar të pandehurit numrin e transaksionit dhe emrin e personit që i ka dërguar paratë.

Në orën 17:15:10¹⁴⁹ i pandehuri (xxx) ka biseduar me O.B. (xxx) dhe ia ka shprehur atij pezmatimin se ka mundur t’i marrë paratë për ta paguar “mekanikun”.

Në orën 22:28:39¹⁵⁰ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një sms O.B. (xxx) ku i ka thënë

“Jam me këtë shokun tim të cilin e ke thirrur sonte, nuk kemi mundur t’ia dërgojmë ato personit të mirëmbajtjes, do ta rregullojmë këtë nesër në mëngjes, pastaj të dielën në mëngjes atje...”

Duke u mbështetur në një urdhër për zbulimin e të dhënave financiare, Unioni Financiar ka zbuluar dokumentacionin që ka vërtetuar se më 8 qershor 2012 është bërë një transferim i parave në shumën prej 1,900 euro përmes Western Unionit nga L.Z. te M.A. Numri ‘MTCN’¹⁵¹ i transferimit ka qenë xxx.¹⁵²

9 qershor 2012

Në orën 17:02:05¹⁵³ i pandehuri (xxx) ka biseduar me O.B. (xxx) dhe ka thënë

“Sapo e dërgova atë shokun tim për të shkuar te shoku yt. Ai sapo u nis...vendi duhet të përgatitet për nesër...mbaje telefonin të kyçur”

Në orën 17:26:21¹⁵⁴ O.B. (xxx) ka biseduar me L.Z. (xxx) dhe i ka thënë atij t’u thotë “p.” dhe “shqiptarëve” që t’i largojnë automjetet e tyre nga garazhi.

Në orën 18:18:12¹⁵⁵, L.Z. (xxx) ka biseduar me O.B.(xxx) dhe kanë diskutuar për largimin e automjeteve nga garazhi dhe bllokimin e hyrjes së përparme.

¹⁴⁷ Dosja IV, f. 432-433

¹⁴⁸ Dosja IV, f. 434

¹⁴⁹ Dosja IV, f. 435-437

¹⁵⁰ Dosja IV, f. 438-439

¹⁵¹

¹⁵² Dosja V faqe 302, 303 dhe 310, 311

¹⁵³ Dosja IV, f. 445-447

¹⁵⁴ Dosja IV, f. 447-490

¹⁵⁵ Dosja IV, f. 451-452

10 qershor 2012

Në orën 09:42:41¹⁵⁶ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku i ka thënë:

“...a je zgjuar shoku im. Edhe dy orë dhe besoj se mund të thërras.”

Pastaj, një sërë porosish me sms janë këmbyer mes të pandehurit dhe R.A. i cili prokuroria pohon se ishte duke vozitur drejt pikës së takimit.

Në orën 13:06:53¹⁵⁷ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një SMS O.B. (xxx) ku i ka thënë:

“Dil te vendi.”

Në orën 13:07:11¹⁵⁸ i pandehuri (xxx) ka biseduar me O.B. (xxx) ku i ka thënë:

“a je duke ardhur te i shtati”

O.B. është përgjigjur se po. Pastaj i pandehuri ka thënë

“ai me targa serbe të regjistrimit...ai është mik i imi, kujdesu për të, tung.”

Ka qenë argumentim i prokurorisë se kjo ka qenë referencë për veturën që ngitej nga R.A. në të cilën është sekuestruar droga. Ai automjet ka pasur targa serbe të regjistrimit, XXX. R.A. ishte duke shkuar drejt Munchen xxx, Karlsfeld, për t'u takuar me L.Z.n dhe O.B.n me qëllim që ta dërgojnë veturën në garazh ku do të shkarkohej ngarkesa e narkotikëve. Referenca në “i shtati” ka qenë referencë për adresën, xxxx Munchen .

Në orën 13:08:15¹⁵⁹ O.B. (xxx) ka biseduar me L.Z. (xxx) dhe e ka pyetur se ku ishte.

Raporti i vëzhgimit¹⁶⁰ shënon se në orën 12:47, L.Z. është larguar nga ndërtesa e njohur si Zweigstrasse 1 dhe ka shkuar në një garazh në të njëjtën adresë ku e ka hapur derën, ka shkuar brenda dhe pastaj e ka mbyllur. Pastaj ai është larguar nga ajo adresë me biçikletë dhe ka shkuar në Munchen xxx në Karlsfeld. Në orën 13:13, ai i është afruar një automjeti Opel Astra me ngjyrë metalike me targa serbe të regjistrimit XXX në Munchner xxx, Karlsfeld. Kur është kthyer me biçikletën e tij në orën 13:15, ai përcillej nga Opel Astra që ngitej nga R.A.. O.B. pastaj është larguar nga xxx 1 dhe ka biseduar me R.A.n. Në orën 13:18, R.A. e ka futur veturën në garazh. Që të tre kanë hyrë në garazh.

Në orën 13:25, O.B., L.Z. dhe R.A. janë arrestuar nga policia gjermane.

Në orën 13:26:00¹⁶¹ i pandehuri (xxx) ia ka dërguar një sms O.B. (xxx) ku i ka thënë:

“më thirr kur të vjen ai.”

Nuk ka pasur përgjigje nga O.B. sepse ishte dërguar në ndalim.

¹⁵⁶ Dosja IV, f. 452-453

¹⁵⁷ Dosja IV, f. 454

¹⁵⁸ Dosja IV, f. 455-457

¹⁵⁹ Dosja IV, f. 458-459

¹⁶⁰ Raporti për Aktivitetet e Vëzhgimit të 10.06.2012, datë 13.06.2012, Dosja II, f. 366-369

¹⁶¹ Dosja IV, f. 459

b. Kontrollat dhe arrestimet

i. Arrestimi i R.A., O.B. dhe L.Z. dhe kontrollat e vijuese

Opel Astra, numri i regjistrimit XXX i drejtuar nga R.A. është konfiskuar nga Policia më 10 qershor 2012. Gjatë kontrollimit të makinës në fjalë policia ka gjetur pas panelit të instrumenteve tri paketime të mbështjella me shirit të zi që përmbanin pluhur¹⁶². Në makinë janë gjetur dy shënime. Në njërin ishte e shënuar adresa “xxx, Karlsfeld Rothschaige”, kurse në tjetrën ishte i shkruar numri i telefonit ‘xxx’. Ky ishte numri i përdoruar nga O.B..

Gjatë ekzaminimit u gjet se të tri paketimet kishin peshën bruto prej 0.554, 0.546 dhe 0.336 kg respektivisht 1.436 kg në total. Pas analizave¹⁶³, pesha neto e pluhurit ishte 1.293 kg dhe është gjetur që përmbante heroin, paracetamol dhe kofeinë. Përpjesa e heroinës në pluhur u gjet të ishte 11%.

Nga dokumentacioni për pagesat e tarifës rrugore dhe të dhënat e marra nga pasaporta e R.A. tregojnë se makina dhe vozitësi kishin dalë nga Serbia dhe se makina kishte kaluar kufirin Serbi-Hungari pak pas mesnatës].

Nga makina Opel Astra janë marrë dy telefona celularë,¹⁶⁴

- a. Telefoni celularë Nokia 1616 (IMEI: xxx) me kartelë SIM të IPKO-s me numër xxx. Pas ekzaminimit, telefoni i dorës kishte të ruajtur tre numra telefoni. Numrin xxx nën emrin ‘H.’.
- b. Telefoni celularë Nokia 5000d (IMEI: xxx) me SIM kartelë të Telenor-it me numër xxx. Nën numrin 331 gjendej emri ‘Sh.A.’ dhe numri xxx¹⁶⁵. Gjykata caktoi një ekspert i cili gjeti “probabilitet të lartë” të përputhjes së zërit të pandehurit gjatë analizimit të përgjimit të personit që shfrytëzonte këtë numër.¹⁶⁶

(ii) Arrestimi i O.B. dhe bastisjet që pasuan.

O.B. është arrestuar më 10 qershor 2012

O.B. në momentin e arrestimit në posedim kishte një shumë parash të gatshme në vlerë prej 9,940 Euro.

162Të dhënat e rastit në lidhje me rastin e kontrollimit të veturës Opel i datës 10.06.2012, Dosja II, faqe 313-324ë foto-albumi për makinën dhe Narkotikët i datës 14.06.2012, Dosja II, faqe 287-311

¹⁶³Raporti mbi ekzaminimin e narkotikëve i datës 04.12.2012, Dosja II, faqe. 312A-312F

¹⁶⁴Vlerësimi i dëshmive të R.A. i datës 14.08.2012 Dosja II, pp.325-330, 338-344 dhe raporti shtesë i datës 31.10.2012, faqe. 331-337, 345-351

¹⁶⁵Ka një gabim në përkthim. Versioni në Anglisht i referohet numrit xxx. Versioni origjinal në Gjermanishte i referohet numrit xxx

¹⁶⁶Raporti i datës 17 dhjetor 2013, faqe 7 (Versioni Anglisht)

Pas bastisje që pasoi në lokalet e tij në xxx Karlsfeld, Zweigstr 1, policia konfiskoi një zarf me faturë të Western Union për 1,000 Euro në emër të L.Z.. Policia gjithashtu ka konfiskuar një biletë fluturimi të datës 1 prill 2012 në relacionin Tiranë–Munih .¹⁶⁷

Gjatë asaj bastisje policia ka konfiskuar disa telefona celularë. Ekzaminimi i telefonave tregoi një komunikim të gjerë në mes të O.B. dhe të pandehurit disa ditë përpara arrestimit të tij më 10 qershor 2012.¹⁶⁸

Policia gjithashtu kishte kontrolluar edhe makinën BMW me tabela regjistrimi xxx me ç ‘rast kishin konfiskuar një telefon mobil Nokia 1800 me numër xxx¹⁶⁹. Në adresarin e telefonit janë nxjerrë dy kontakte të cilët përdoruesin e telefonit e lidhin të Pandehurin. Njëri numër ishte e i renditur me emrin ‘Sh’ me numër xxx. Trupi Gjykues konstatoi se ky numër ishte përdorur nga i pandehuri. Ky numër gjithashtu është gjetur edhe në telefonin e konfiskuar prej G.Y. dhe M.K.. Emri i dytë i renditur ishte ‘Sh. K.’ me numër telefoni xxx. Trupi Gjykues konstatoi se ky numër është përdorur nga i pandehuri.

Gjatë kontrollimit të lokalit të tij¹⁷⁰ policia ka konfiskuar një telefon Mobistel Elson EL 600 dual SIM me dy kartela SIM në të.¹⁷¹ Në memorien telefonit të cekur dhe në kontaktet e regjistruara në O2 SIM kartelën me numër telefoni xxx, janë gjetur disa kontakte, njëri nga ta me emrin ‘Q.L’ me numër telefoni xxx. Trupi Gjykues konstatoi se ky është numër i përdorur nga i pandehuri. Hetuesit gjithashtu kanë gjetur dy numra të telefonit të renditur- xxx me emrin ‘M. O2’ dhe xxx me emrin ‘M. O2’–numra të telefonit për të cilët Trupi Gjykues konstatoi se i takojnë dhe janë përdorë nga L.Z..

Policia gjithashtu ka konfiskuar edhe një Sony Ericsson X10 me kartelë SIM me numër xxx.¹⁷² Ky është numri i telefonit i cili ka qenë në kontakt me numrin xxx. Trupi gjykues konstatoi se xxx është numri i cili është përdorë nga i Pandehuri. Në telefon dhe në kartelën SIM ishin të renditur kontakte të ndryshëm, duke përfshirë edhe emrin ‘xxx.I’ me numrin xxx. Numri i telefonit xxx gjithashtu ka qenë i regjistruar në telefon dhe në kartelën SIM nën emrin ‘M. O2’. Trupi Gjykues konstatoi se ky është numri i telefonit i përdorur nga L.Z..

(iii) Arrestimi i L.Z. dhe bastisjet pasuese

L.Z. është arrestuar më 10 qershor 2012.

Një telefon mobil dhe një kartelë SIM janë konfiskuar e që ishin në posedim të L.Z..¹⁷³ Telefoni ishte Nokia 1616 me kartelë SIM me numër xxx. Ky ishte numri i telefonit përmes të cilit ai ka pasur kontakte të shpeshta me O.B.n (xxx). Gjithashtu është gjetur i ruajtur edhe në kartelën

¹⁶⁷Deklaratë mbi konfiskimin , O.B. e datës 10.06.2012, Dosja II, faqe. 374-381

¹⁶⁸Ekzaminimi i eksponateve të O.B.t i datës 25.07.2012, Dosja II, faqe. 382-407

¹⁶⁹Po aty., faqe. 382-3, 395-6

¹⁷⁰Po aty., faqe. 384-394, 395-407

¹⁷¹Po aty., faqe. 384

¹⁷²Po aty., faqe. 386

¹⁷³Ekzaminimi i eksponateve të L.Z. , Dosja II, faqe. 408-427

tjetër O2 kartelën SIM (xxx) të O.B.t. I dyti, një Vodafone, me numër të kartelës SIM xxx është konfiskuar gjithashtu. Ekzaminimi i kësaj karte SIM tregon se kjo kartelë është përdorë për të kontaktuar numrin e telefonit xxx¹⁷⁴. Trupi Gjykses konstatoi se ky numër telefoni është përdorë nga i pandehuri.

(iv) *Arrestimi i të pandehurit*

I pandehuri është arrestuar më 23 janar 2013.

Më datë 20 maj 2012 i pandehuri (xxx) bisedon me 'F' (xxx) dhe gjatë asaj bisede thotë

*“Adresa ime është xxx”*¹⁷⁵

I pandehuri është arrestuar me 23 janar 2013 në banesën e tij në xxx në Prishtinë. Lagjja xxx parë është njohur si xxx.

Kjo provë mbështet konstatimin e Trupit Gjykses se numri xxx është numri që e ka poseduar dhe përdorur i pandehuri.

ii. *Hetimet ku përfshihet i pandehuri F.F. i njohur si 'F'*

Është argumentim i prokurorisë se F.F., i njohur si 'F', gjithashtu ishte përfshirë në një ndërmarrje kriminale. Konkretisht pretendohej se F.F. ishte pranuesi i menduar i drogës së importuar nga i pandehuri.

Gjatë përgjimit të telefonit mobil me numrin xxx, për të cilin Trupi Gjykses konstatoi se ishte në posedim dhe përdorim të të pandehurit, i pandehuri komunikonte me numrin e telefonit xxx. Trupi gjykses konstaton se numri i telefonit ishte i regjistruar në emër të F.F..¹⁷⁶

Në ora 11:35:09 të datës 23 maj 2012¹⁷⁷, F.F. (xxx) i dërgon një SMS të pandehurit (xxx) ku ai shkruan

“Jam unë F.”

Në ora 17:35:11 të datës 25 maj 2012¹⁷⁸ F.F. (xxxx) flet me të pandehurin (xxx) dhe i thotë:

“...Nuk duket mire me letra...para te parit, shpresoj qe te ndodh transporti. Pas dy ditësh unë mund të paguaj. Do të ju thërras më vonë kur të marr vesh diçka më shumë...”

Është argumentim i prokurorisë se gjatë këtij komunikimi F.F. i referohet faktit se ai po përpiqej të siguronte paratë (“*letrat*”) por ai dëshironte që dërgesa e narkotikëve të i dorëzohej para datës 1 të muajit.

¹⁷⁴SMS me 2 maj 2012 në ora 12:40

¹⁷⁵ Doja e V-të, faqe 8

¹⁷⁶

¹⁷⁷ Dosja IV, faqe. 461

¹⁷⁸ Dosja IV, faqe. 461

Në ora 15:22:31¹⁷⁹ të datës 2 qershor 2012 F.F. (xxx) i dërgoi një SMS të pandehurit (xxx) me të cilin i thoshte:

“Çfarë po ndodh F? A mundem me u mbështet në ty?Më duhet data urgjentisht.F.”

Në ora 15:24:39¹⁸⁰ të datës 2 qershor 2012 i pandehuri (xxx) i dërgon një SMS F.F.-it (xxx) ku i thotë

“a ke bërë diçka?”

Në ora 16:44:48¹⁸¹ të datës 2 qershor 2012 i pandehuri (xxx) i dërgon në SMS F.F.-it (xxx) ku ai thotë

“ti duhet të i dërgosh paratë. A ke diçka”

Në ora 16:46:49¹⁸² të datës 2 qershor 2012 F.F. (xxx) i dërgon SMS të pandehurit (xxx) ku ai thotë:

“jo, më vjen keq nuk ka asgjë. Po më ndihmon një shok sa me mbetë gjallë”.

Gjatë këtyre bisedave telefonike me F.F. i pandehuri përdorte numrin xxx e që ishte numri të cilin M.A. gjersa jetonte me të pandehurin e përdorte për të kontaktuar të motrën.

iii. Dëshmia e dëshmitarit

M.L., Hetues i Krimeve në Munich, Republika Federale e Gjermanisë, ish polic i EULEX-it në njësinë kundër krimit të organizuar, ka dhënë dëshmi para Trupit Gjykses më datë 11 dhjetor 2013. Dëshmia e tij është ofruar përmes video-linkut nga një gjykatë në Gjermani.

Oficeri L. konfirmoi se ka qenë i punësuar në EULEX ndërmjet muajit shkurt 2012 dhe shkurt 2013, dhe se gjatë kësaj kohe ai ka qenë udhëheqës ekipi i njësisë së hetuesisë në NJHKO. Oficeri L. konfirmoi se pasi që hetimet kishin nisur në Gjermani dhe ishin bartur në Kosovë ai ishte caktuar të negociojë me autoritetet Bavareze, se ai ishte përgjegjës për raportet e nxjerra nga policia Bavareze dhe se ai ishte përgjegjës për arkivimin dhe përkthimin e hetimeve në Kosovë.

Oficeri L. më tej konfirmoi se, në bazë të informacionit të marrë nga Gjermania, besohej se disa numra të telefonit kishin lidhje me pretendimet. Ky informacion përshpejtoi hapjen e një hetimi nga ana e PSRK-së, dhe më pas janë bërë kërkesa për urdhëra, të cilët u miratuan, nga gjyqtari i procedurës paraprake që të urdhërojë masat e fshehta kundër të pandehurit. Oficeri L. i konfirmoi Trupit Gjykses që NJHKO ishin të përfshirë në hetimin e pretendimeve që përfshijnë të pandehurin që nga maji 2012 deri në arrestimin e tij.

¹⁷⁹ Dosja IV, faqe. 479

¹⁸⁰ Dosja IV, faqe. 479

¹⁸¹ Dosja IV, faqe. 480

¹⁸² Dosja IV, faqe. 481

Zyrtari L. gjithashtu i konfirmoi trupit gjykues se i pandehuri është arrestuar më 23 janar 2013 në vendbanimin e tij dhe se të pranishme ishin NJHKO (përfshirë këtu edhe oficerin L.) edhe Policia e Kosovës.

Zyrtari L. konfirmoi se pak pas kësaj ka lënë misionin, por para se të bënte këtë ai përpiloi një raport përfundimtar për hetimet në mënyrë që pasardhësi i tij, oficeri S., të mund të vazhdojë hetimet.

Zyrtari L. konfirmoi se data e mundshme e largimit nga misioni është 13 shkurti i vitit 2013.

Avokati i të pandehurit e kundërshtoi dëshminë e dëshmitarit si të paqëndrueshme duke pas parasysh faktin se dëshmitari ishte zyrtar policie.

Trupi Gjykues vuri në dukje se një kundërshtim i tillë, bazuar në supozimin se një dëshmitar i policisë është palë në procedurë, për pasojë ka interes në rezultatin përfundimtar, dhe për këtë arsye—me përfshirjen e mëtejme – ka motiv të sajohet dëshmi, është diçka që është e pambështetur në prova, dhe për këtë arsye është një pohim i thjeshtë që nuk meriton vëmendje serioze nga Trupi Gjykues

Trupi Gjykues konstatoi se zyrtari L. është dëshmitar i besueshëm i cili ka dhënë dëshmi të besueshme.

A,S., Hetues i Krimeve, Republika e Turqisë, i pajtuar si Polic në EULEX , Njësia Kundër Krimet të Organizuar, dha dëshminë e tij më 4 dhjetor 2013.

Zyrtari S. u është bashkangjitur hetimeve kundër të pandehurit në pjesën e dytë të qershorit 2012 dhe që nga ajo kohë ai ka qenë “zyrtari përgjegjës” për rastin që e kishte zyrtari L..

Zyrtari S. konfirmoi se ai ka marrë detyrën në implementimn, zbatimin dhe analizimin e provave të marra në pajtim me masat e fshehta të ndryshme.

Ai konfirmoi se pas marrjes së rolit të tij ai ka ekzaminuar të gjitha urdhëresat për masa te fshehta që ishin lëshuar për rastin, e në veçanti Urdhri i nxjerrë me datë 16 maj 2012 i cili u referohet dy numrave telefonikë (përfundojnë me xxx dhe xxx). Ai vazhdoi të konfirmojë se urdhri për telefonin -0810 ishte regjistruar në një kompakt disk.

Është konfirmuar se Zyrtari S. iu bashkua hetimeve pas arrestimeve në Gjermani që kishin ndodhur më 10 qershor 2012 dhe për këtë arsye dëshmia e kishte të bënte me ato dokumente që ai i pa pas mbërritjes së tij dhe veprimet e ndërmarra prej tij nisën prej atij dokumentacioni.

Prova në lidhje me tekstet e SMS-ve i shin paraqitur zyrtarit S.

Zyrtari S. konfirmoi se ka qenë i pranishëm në momentin e arrestimit të pandehurit në atë adresë që ishte identifikuar përmes komunikimit telefonik në mes të pandehurit dhe një personi tjetër.

Vendbanimi i të pandehurit në atë adresë ishte kontrolluar nga ekipi i NJHKO/PK. I pranishëm ishte i pandehuri dhe dy vajzat e tij, partnerja e tij Z.V dhe M.A..

Zyrtari S. nuk u mor në pyetje të tërthortë nga avokati mbrojtës për arsyet që u përmenden më lartë në lidhje me oficerin L. .

iv. Deklaratat

a. I pandehuri

Më 15 Maj 2013, i pandehuri u intervistua nga Prokurori ¹⁸³. Numra të ndryshëm telefoni iu ishin vënë përpara dhe një numër i përgjimeve iu lëshuan për të i dëgjuar. Ai mohoi se zëri i regjistruar gjatë përgjimeve telefonike të ishte i tij.

Ai prapë është intervistuar më 30 maj 2013¹⁸⁴. Gjatë asaj interviste atij i është lëshuar regjistrimi i përgjimit të komunikimit telefonik në ora 10:55 i datës 1 qershor 2012 dhe është pyetur nëse i njihje zërat e dy femrave që dëgjoheshin duke biseduar. I pandehuri i identifikoi zërat si të M.A. për të cilën tha se e është gruaja e tij e dytë me të cilën bashkëjeton dhe se tjetri zë është i Shkurtës motrës së saj më të re.

I pandehuri refuzoi të nënshkruajë procesverbalin e asaj interviste.

F. KONSTATIMET NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË E TË AKUZUARIT

I pandehuri është akuzuar për rolin e tij në organizimin dhe pjesëmarrjen në blerjen, shitjen, transportin, dorëzimin dhe eksportimin nga Kosova dhe importimin e saj në Republikën Federale të Gjermanisë përmes vendeve tjera Evropiane të 1.49 kg të heroinës së konfiskuar më 20 shkurt 2012 dhe edhe 1.43 kg të heroinës konfiskuar më 10 qershor 2012.

Policia në Gjermani ka ndërmarrë një operacion në identifikimin dhe përfundimisht arrestimin e trafikuesve të pretenduar.

Gjatë hetimeve policia ka identifikuar të pandehurin. Pas kësaj policia ka monitoruar aktivitetet e tij përmes mënyrës së përgjimit të telefonit të tij në gjermani dhe në Kosovë dhe ka vënë nën vëzhgim të dyshimtë të ndryshëm

I pandehuri është arrestuar në Kosovë më 23 janar 2013.

Lënda e prokurorisë më së shumti mbështetet në provat e përgjimeve telefonike. Pjesa më e madhe atyre provave është pranuar nga organet relevante në Republikën Federale të Gjermanisë në përgjigje të kërkesës për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare. Trupi Gjykses konstatoi se ato

¹⁸³Procesverbali i intervistimit të të dyshuarit 15 maj 2013 dosja V, faqe. 316-330

¹⁸⁴Procesverbali i intervistimit të të dyshuarit 30 maj 2013 dosja V, faqe. 345-358

kërkesa janë ligjore dhe se provat janë marrë në mënyrën e duhur dhe janë të pranueshme për gjykatën.

Trupi Gjykues nuk propozon që këtu tani të përsëriten të gjitha gjetjet faktike që janë referuar dhe të cilat përbejnë një pjesë të konstatimeve në lidhje me përgjegjësinë e të pandehurit .

Gjatë hetimeve policore janë arrestuar disa të dyshuar në Gjermani. L.G., M.K., D.K. dhe R.A. akuzohen për veprë penale në lidhje me drogë. L.G., M.K. dhe D.K. janë dënuar në lidhje me konfiskimin e heroinës me datë 20 shkurt 2012. R.A., O.B. dhe L.Z. janë dënuar për veprat penale në lidhje me heroinës e konfiskuar më 10 qershor 2012.

Ka qenë argumentim i prokurorisë se i pandehuri ishte në qendër të një grupi të organizuar kriminal mirë i strukturuar që ishte përgjegjës për eksportimin e heroinës nga Kosova dhe importimin e drogës në Gjermani në dy datat konkrete duke përdorur ndërmjetës, shpërndarës dhe përdorues të ndryshëm që ishin të stacionuar në Munihi të Gjermanisë.

Kur i pandehuri ka dhënë dëshmi para kësaj gjykate ka thënë se nuk i njeh L (L) G, D.K., O.B. dhe R.A.. Ai tha se e njeh G.Y. dhe se e ka shok megjithëse siç tha ai nuk ka folur me të që kur se është kthyer në Kosovë. Ai tha se M.K. është dhëndëri i tij por se asnjëherë nuk e ka takuar ose biseduar me të. Kjo ishte gënjeshtër. Provat nga telefoni mbi të cilat prokuroria mbështet lëndën e saj provojnë se i pandehuri ka komunikuar përmes telefonit me O.B., G.Y., R.A. dhe M.K..

Ndërmjet 1 janarit 2012 dhe 21 shkurtit 2012 i pandehuri, M.K., O.B., L.G., Y.G. dhe D.K. rregullisht kishin kontakte në mes vete.

Më 20 shkurt 2012 M.K. dhe D.K. janë arrestuar nga Policia Gjermane në xxx, në Gjermani. M.K. ka qenë duke vozitur veturën Toyota Corolla me tabela regjistrimi xxx ku me të ishte edhe D. Vetura e përmendur Toyota ishte e regjistruar në emrin e të ëmës së të pandehurit S.V. .

Gjatë bastisjes së veturës që ka pasuar, policia konfiskon tri paketime të mbështjella të cilat përmbanin përafërsisht 1.49 kg heroin.

Paraprakisht i pandehuri ishte marrë vesh që M.K., i fejuari i motrës së tij A.V, të rekrutonte D.K. me ç ‘rast ai ka vepruar si personi të cilin M.K. e kishte sjellë me veturë, kishte marr narkotikët nga L.G. dhe pastaj ishte kthyer para se ato të ia dorëzonte M.K..

Gjatë përgjimit të bisedës telefonike të O.B. pas arrestimit të M.K. i pandehuri deklaroi: “...nëse e marrin vesh familjarët se unë e kam dërguar atë, katastrofë”.

Më pastaj i pandehuri ka pasur një bisedë trefishtë me të atin, T.V., dhe motrën e tij A.V. me ç ‘rast ata i referoheshin njëri tjetrit me emër. I ati i të pandehurit e pyeste atë për arrestimin e M.K.t.

Në javët para arrestimit të M.K., D.K. dhe L.G. me 20 shkurt 2012, i pandehuri kryesisht ka përdorur katër¹⁸⁵ telefona celularë që të ndërlidhej me anëtarët e tjerë të grupit kriminal.

Gjatë kontrollimit të veturës Toyota Corolla e vozitur prej M.K. ku me të ishte edhe D.K. , policia ka konfiskuar dy telefona mobil. Trupi Gjykues konstatoi se ata telefona kanë qenë në posedim dhe janë përdorur nga M.K.. Nga memoria e njërit prej telefonave janë nxjerrë tre¹⁸⁶ prej katër numrave që ishin përdorë nga i pandehuri disa javë para arrestimit të tij më 20 shkurt 2012. Nga memoria e telefonit të dytë janë nxjerrë tre¹⁸⁷ nga numrat që i ka përdorë i pandehuri. Secilit numër i ishte dhënë edhe një pseudonim.

G.Y. është arrestua më 9 maj 2012. Telefoni që e ka poseduar është ekzaminuar dhe është gjetur se përmban disa numra telefoni që janë gjetur në telefonat në posedim të M.K.t pas arrestimit të tij. Numri i telefonit xxx ishte renditur nën emrin ‘A’. Numri i telefonit xxx gjithashtu ishte renditur nën emrin ‘A’. Numri i telefonit xxx ishte renditur nën emrin ‘A.’. Numri i telefonit xxx ishte renditur nën emrin ‘A’. Përveç kësaj kartela SIM e konfiskuar nga G.Y. kishte të renditur dy kontakte. I pari me numrin xxx ishte renditur nën emrin ‘A’. Numri i dytë xxx ishte renditur nën emrin ‘A’.

Nga muaji prill 2012 ka pasur një periudhë të komunikimeve të gjera ndërmjet të pandehurit dhe O.B.t nga e cila është e qartë se ata tentonin të aranzhonin ngarkesa tjera me narkotikë.

I pandehuri kryesisht përdorte numrat e telefonit xxx dhe xxx. I pandehuri ka lidhje me këta numra përmes M.A., gruan e tij të dytë me të cilën bashkëjeton.

Më 6 qershor 2012 i pandehuri dhe O.B. bisedonin se si mund të transferonin paratë nga Gjermania për në Kosovë përmes Western. Më 7 qershor 2012 duke përdorur numrin e telefonit xxx, i pandehuri i dërgon një SM O.B. ku i thotë: “*Emri është M.A.*”

Më 8 qershor 2012 L.Z. i dërgon një SMS O.B.t ku i shkruan: “xxx”

Të dhënat financiare tregojnë se me 8 qershor 2012 Western Union-i ka transferuar një shumë të parave prej 1,900 Eurosh që janë dërguar nga L.Z. për M.A.n. Numri i transferit ishte xxx.

Numri i telefonit xxx ishte përdorë nga ana e të pandehurit për të diskutuar dërgesën e drogës. Më 1 qershor 2012 M.A. e ka përdorë atë numër telefoni të bisedojë me motrën e saj Sh. Kur i pandehuri u intervistua më 30 maj 2013 ai e identifikoi zërin në përgjim si zëri i M. Numri që e kishte thirrë M.A. ishte i regjistruar në emër të B A , i ati i M. dhe Sh.A.. Me rastin e arrestimit të të pandehurit më 23 janar në banesën e tij M.A. ishte aty. I pandehuri i pranoi këto fakte edhe gjatë gjykimit¹⁸⁸.

¹⁸⁵ xxx, xxx, xxx dhe xxx

¹⁸⁶ xxx, xxx dhe xxx

¹⁸⁷ xxx, xxx dhe xxx

¹⁸⁸ Minutes of 8 January 2014

Numrat e telefonit: xxx dhe xxx ishin përdorë për të u lidhur me anëtarët e tjerë të këtij grupi të organizuar kriminal për të siguruar që L.Z. dhe O.B. të ishin në gjendje të drejtonin korrierin R.A. te adresa në Munchen xxx.

Provat e vëzhgimi e tregojnë L.Z.n duke shkuar te ajo adresë me biçikletë e më vonë duke e drejtuar atje automjetin Opel Astra me tabela regjistrimi XXX vozitur nga R.A. deri te adresa në xxx ku po priste O.B., L.Z., R.A. dhe O.B. janë arrestuar më 10 qershor 2012. Automjeti Opel Astra i është nënshtruar kontrollit me ç ‘rast janë konfiskuar 1.43 kg drogë.

Gjatë kontrollimit të Opel Astra-s policia ka konfiskuar dy telefona celularë.

Në memorien e njërit prej telefonave, nën emrin “Sh.A.” ishte regjistruar numri xxx. Ky ishte po i njëjti numër që ishte i regjistruar në telefonat celularë të G.Y. dhe M.K.. Ishte po i njëjti numër të cilin i pandehuri e ka përdorë më 20 shkurt 2012 të fliste me motrën e tij, të atin e saj dhe me O.B.n. Në të vërtetë me 20 maj 2012 një person i gjinisë mashkull për të cilin prokuroria pohon se ishte i pandehuri duke përdorur numrin e telefonit xxx thotë “adresa ime xxx”¹⁸⁹ kjo ishte adresa në të cilën është arrestuar i pandehuri më 23 janar 2013.

Gjatë atij kontrollimi policia kishte konfiskuar disa telefona celularë. Ekzaminimi i telefonave tregon një komunikim të gjerë në mes të pandehurit dhe O.B. në ditët para arrestimit të tij më 10 qershor .¹⁹⁰

Policia gjithashtu ka kontrolluar edhe automjetin BMW me tabela regjistrimi xxx in në posedim dhe përdorim të O.B.t me ç’ rast kanë konfiskuar një telefon celular NOKIA 1800 me numrin xxx¹⁹¹. Nga adresari i atij telefoni janë nxjerrë numrat e telefonit xxx dhe xxx. Trupi Gjykses konstatoi se këta numra të telefonit janë përdorë nga i pandehuri.

Gjatë kontrollimit të lokaleve të tij¹⁹² policia ka konfiskuar një telefon Mobistel Elson EL 600 dual SIM me dy kartela SIM brenda¹⁹³. Në memorien telefonit të cekur dhe në kontaktet e regjistruara në O2 SIM kartelën me numër telefoni xxx, janë gjetur disa kontakte, njëri nga ta me emrin ‘xxx L.’ me numër telefoni xxx. Trupi Gjykses konstatoi se ky është numër i përdorur nga i pandehuri. Hetuesit gjithashtu kanë gjetur dy numra të telefonit të listuar- xxx me emrin ‘M O2’ dhe xxx me emrin “M O2’-numra të telefonit për të cilët Trupi Gjykses konstaton se i takojnë dhe janë përdorë nga L.Z.

Policia gjithashtu ka konfiskuar edhe një Sony Ericsson X10 me kartelë SIM me numër xxx.¹⁹⁴ Ky është numri i telefonit i cili ka qenë në kontakt me numrin xxx. Trupi Gjykses konstaton se xxx është numri i cili është përdoruar nga i Pandehuri. Në telefon dhe në kartelën SIM janë të renditur kontakte të ndryshme, duke përfshirë edhe emrin ‘xxx I’ me numrin xxx.

¹⁸⁹ Dosja V, faqe 8

¹⁹⁰ Ekzaminimi i gjëseneve të O.B.t me date 25 korrik 2012, Dosja II, faqe 382-407

¹⁹¹ Po aty, faqe. 382-3, 395-6

¹⁹² Po aty , faqe. 384-394, 395-407

¹⁹³ Po aty, faqe 384

¹⁹⁴ Po aty., faqe. 386

Numri i telefonit xxx gjithashtu ka qenë i regjistruar në telefon dhe në kartelën SIM nën emrin 'M O2'. Trupi Gjykses konstaton se ky është numri i telefonit i përdorur nga L.Z..

Kur është arrestuar L.Z. i ishte ekzaminuar edhe telefoni ku u gjeten prova të komunikimit me SMS me numrin xxx.

I pandehuri është akuzuar për Krim të Organizuar në bazë të nenit 274 paragrafi 1,2 dhe 3 i KPK-së .

Sipas nenit 274 "krimi i organizuar" do të thotë veprë penale e rëndë e kryer nga një grup i strukturuar me qëllim që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të vijnë deri te përfitimi financiar apo përfitim tjetër material.

Neni 274 paragrafi 7, nën paragrafi 2 "grup i organizuar kriminal" që i referohet 'grup i strukturuar' që ekziston për një periudhë kohore (i); (ii) vepron bashkërisht ; (iii) me qëllim të kryerjes së një apo më shumë krimeve të rënda; (iv) me qëllim që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të vijnë deri te përfitimi financiar apo përfitim tjetër material.

Shprehja "krim i rëndë" do të thotë vepra penale e dënueshme së paku me 4 vite burgim..

Shprehja "grup i strukturuar" do të thotë grup prej tre ose më shumë personave që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një veprë penale dhe nuk duhet të ketë përcaktuar zyrtarisht rolet e saj për "anëtarët, vazhdimësinë e anëtarësisë ose të strukturës së zhvilluar

I pandehuri është dënuar për rolin e tij sipas dy pikave të aktakuzës : blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229, paragrafi 3 i Kodit Penal të Kosovës .¹⁹⁵

Veprat penale ishin kryer gjatë periudhës 1 janar -10 qershor 2012. Gjyqtari i Procedurës Paraprake konstatoi se gjatë asaj periudhe kohore grupi ka qenë aktiv.

Trupi Gjykses konstatoi se i pandehuri ka kryer veprën penale nën pikën 1 të aktakuzës si pjesëtar i grupit të organizuar kriminal që përfshinte M.K., D.K., L.G., O.B. dhe G.Y.. Trupi Gjykses konstatoi i pandehuri ka kryer veprën penale nën pikën 2 të aktakuzës si pjesëtar i grupit të organizuar kriminal që përfshinte R.A., O.B. dhe L.Z.. Në lidhje me të dy pikat e aktakuzës i pandehuri ishte anëtar i grupit që përfshinte më shumë se tre apo më shumë persona. Për më tepër, nuk kërkohet vazhdimi i të qenit pjesëtar. Grupi ka ekzistuar për qëllim të blerjes, transportimit, dorëzimit dhe eksportimit nga Kosova të drogës së rrezikshme dhe substancave psikotropike dhe importimit e tyre në Republikën Federalë të Gjermanisë përmes vendeve tjera të Evropës.

Trupi gjykses konstatoi se i pandehuri ka organizuar, mbikëqyrë dhe menaxhuar aktivitetet e grupit kriminal. Nga telefonatat e përgjuara shihet qartë se i pandehuri ka kontaktuar pjesëtarët e

¹⁹⁵ Korrespondon me nenet 273 dhe 279 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligji04/L-082 i 2012-ës (Kodi i Ri)

grupit kriminal duke i informuar ata për datat dhe mënyrën e arritjes së dërgesave të drogës, ka drejtuar rolet dhe aktivitetet e tyre dhe pas arrestimeve të muajit shkurt u ka sugjeruar anëtarëve të grupit të i ndërrojnë kartelat SIM të telefonave të tyre celularë.

Në kuptimin e sasisë së drogës, policia e Republikës Federale të Gjermanisë me datë 20 shkurt 2010 ka konfiskuar 1.496 kg heroin. Me 10 qershor 2012 policia ka konfiskuar 1.436 kg heroin.

Trupi Gjykses konstaton se kanë qenë sasi të mëdha komerciale. I pandehuri është shpallur fajtor në dy pika sipas nenit 229, paragrafi 3 i KPK-së për pjesën e tij në kryerjen e krimeve të rënda. Këto vepra janë kryer për të siguruar përfitim financiar.

Informatat e siguruar nga bankat në Kosovë, nuk zbulojnë asnjë llogari bankare në emër të të Pandehurit. Megjithatë, do të ishte disi imagjinare të sugjerohet që i pandehuri po importonte sasi të mëdha të heroinës në Gjermani pa siguruar ndonjë përfitim financiar. Me të vërtetë, më 18 shkurt 2012, i Pandehuri ka udhëzuar M.K. për të shkuar në Aubing të nesërmen për të marrë disa “gjëra” të cilat pastaj duhet t’i dërgojë në Karlsfeld. Ai i tregoi M.K. se do të merrte për vete 300 euro nga një i ri dhe më pas edhe 2,000 euro që ishin për të Pandehurin. Po ashtu është dëshmia e transferit të parave të Western Union që L.Z. kishte dërguar nën emrin e gruas pa kurorë të të pandehurit, M.A..

Trupi Gjykses konstatoi që F.F. ka qenë marrësi i synuar i dërgesës së drogës. Megjithatë, Trupi Gjykses nuk e konstatoi që ai ishte pjesë e grupit të krimit të organizuar.

Trupi Gjykses dëshmoi, sipas standardit të kërkuar, elementet e nenit 229, paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe që janë implicite në veprën e “trafikimit” sipas paragrafit 3 të nenit të cekur. Trafikimi dallon nga “kontrabandimi” i cili është transportimi sekret ndërkuftar i drogave. Kontrabandimi është pjesë përbërëse e trafikimit. Megjithatë, trafikimi përfshin edhe eksportin dhe importin ndërkuftar, blerjen, kontrollin, posedimin me synimin për të shitur ose shpërndarë, shitjem ose ofrimin për shitje të substancave të kontrolluara. Paragrafi 4 i nenit 229 përfshihet në nenin 274.

Prandaj, Trupi Gjykses konstatoi që i Pandehuri ka kryer veprën penale të krimit të organizuar, duke shkelur nenin 274, paragrafi 1 dhe 3 në lidhje me nenin 229, paragrafi 3 i KPK-së sepse në mes të 1 janar dhe 10 janar 2012, i Pandehuri, në territorin e Kosovës, ka organizuar dhe marrë pjesë në blerjen, posedimin, shitjen, transportimin, dorëzimin, eksportimin nga Kosova dhe importimin në RF të Gjermanisë të dy dërgesave të heroinës, konkretisht 1.496 kg. të heroinës të konfiskuara më 20 shkurt 2012 në Munich, RF e Gjermanisë ¹⁹⁶, nga automjeti motorik Toyota Corolla, numri i regjistrimit xxx që drejtohej nga M.K. në të cilin bartaj D.K. dhe 1.436 kg. të heroinës të konfiskuara më 10 qershor 2012 në Munich, RF e Gjermanisë ¹⁹⁷, nga automjeti motorik Opel Astra, numri i regjistrimit XXX i drejtuar nga R.A. dhe i ka gjetur në posedim të R.A., O.B. dhe L.Z.; brenda një grupi të strukturuar së bashku me L.G., M.K., D.K., G.Y.in, O.B., L.Z., R.A. dhe bashkëkryerës të tjerë të pidentifikuar; duke marrë pjesë aktivisht në grupin kriminal; dhe duke organizuar, themeluar, mbikëqyrë, menaxhuar dhe drejtuar aktivitetet

¹⁹⁶ Pika 1

¹⁹⁷ Pika 2

e grupit të cekur; për të siguruar, direkt ose indirekt, përfitim financiar apo përfitim tjetër material.

G. DËNIMI

Trupi Gjykses, para se të merret me ndëshkimin që do të caktohet saktësisht në lidhje me VESELIN dhe para se të përcaktohen faktorët rëndues dhe lehtësues në këtë rast, duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe së fundi, Gjykatës së Apelit në lidhje me rastet ku një person i akuzuar është shpallur fajtor për krim të organizuar.

Dënimi për Akuzën për Krim të Organizuar

Lëndët e **S.A. dhe të tjerët** (Gjykata Supreme e Kosovës, vendimi i datës 2 tetor 2012)¹⁹⁸ dhe **J.P.** (Gjykata e Apelit e Kosovës, vendimi i datës 22 tetor 2013)¹⁹⁹ paraqiten para trupit gjykses për vërtetimin e këtyre propozimeve:

- a. Se dënimi për veprë penale të krimit të organizuar kërkon provën e kryerjes së një 'vepre bazë'.
- b. Se kryerja e krimit bazë është pjesë përbërëse e veprës së krimit të organizuar.
- c. Dhe prandaj, vepra bazë është një nga krimi i organizuar.
- d. Se lejimi i strukturimit ndryshe të dënimit do të ishte i barabartë me dyfishim të penalizimit.²⁰⁰
- e. Se, gjatë strukturimit të dënimit për krim të organizuar, duhet të shqiptohet dënim për veprën që është kryer në lidhje me veprat tjera.
- f. Se për krim të organizuar duhet të shqiptohet një dënim.²⁰¹

Prandaj trupi gjykses në këtë lëndë propozon ta dënoj V-në me dënim me burg për veprën e krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, para 1 dhe 3 të KPK-së, të kryer në lidhje me

¹⁹⁸ Gjykata Supreme e Kosovës Referencë Ap-Kz nr 61/2012; 02 tetor 2012

¹⁹⁹ Gjykata e Apelit Referencë PAKR 4/2013

²⁰⁰ Para 53 i JP, përshtatja e arsytimit të paragrafit 48 të SA

²⁰¹ Arsytimi i paragrafit 55 të Aktgjykimit për J.P

dy vepra tjera të blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve të rrezikshëm neni 229, para 3 e KPK-së. Prandaj Gjykata do të shqiptoj vetëm një dënim, në akuzën për krim të organizuar, dhe për pasojë në këtë lëndë nuk shtrohet çështja e bashkimit të dënimit.

Struktura e dënimit.

1. Së pari, gjykata e konsideron të përshtatshme ta përcaktojë se ku qëndron sjellja e të pandehurit në nivelin e peshës së veprës.
2. Trupi Gjykues pastaj do të identifikojë faktorët rëndues, faktorë të cilët janë relevantë por, që mund të konsiderohen si “neutralë” sa i përket dënimit dhe pastaj të identifikojë faktorët lehtësues. Gjykata pastaj do të peshojë faktorët për të arritur deri te dënimi që do të caktohet.
3. Trupi gjykues thekson që janë tri pika të aktakuzës dhe që i Akuzuari është gjetur fajtor në pikën për krim të organizuar.
4. Trupi gjykues thekson që vepra e pjesëmarrjes aktive në një grup organizuar kriminal është vepër serioze në Republikën e Kosovës. Sipas nenit 274, paragrafi 3, Gjykata mund të caktojë burgim prej shtatë(7) deri në njëzetë (20) vite, dhe një gjobë prej € 500,000. Kësisoj, Trup gjykues ka diskrecion të madh në caktimin e dënimit të duhur.
5. Trupi gjykues iu ka referuar “gjetjeve të saja faktike për përgjegjësinë e të pandehurit.

Para se të vazhdojmë të paraqesin dënimin nocional që duhet ta marrë ky krim, Trupi gjykues e konsideron të përshtatshëm që të identifikojë faktorët rëndues që janë në pranishëm në këtë rast:-

1. Së pari, Trupi Gjykues gjeti që i pandehuri ka organizuar, mbikëqyrë dhe menaxhuar aktivitetet e grupit kriminal. Ky faktor është tepër i rëndësishëm në përcaktimin e fajësisë së tij.
2. Trupi Gjykues po ashtu konsideron që sasia e drogës së konfiskuar, është fjala për 1.496 kg të heroinës dhe 1.436 kg të heroinës përkatësisht, janë sasi e madhe “me shumicë”. Aftësia për të organizuar furnizimin dhe shpërndarjen e sasive me shumicë të heroinës, qartë sygjeron që i Pandehuri ishte mjaft lart në hierarki në lidhje me këtë

dhe Gjykata konsideron që sasia e drogës së konfiskuar të jetë si faktor rëndues sa i përket pikës së krimit të organizuar.

3. Që veprat janë kryer për të siguruar përfitim financiar pa dyshim është një faktor rëndues dhe sygjeron mungesën e ndonjë shtrëngimi p.sh. për të përmbushur varësinë e tij ndaj drogës, që ndoshta mund të neutralizojë (të paktën pjesërisht) stimujt financiar për ta kryer veprën.

Faktorët që as nuk e rëndojnë as nuk e lehtësojnë dënimin:-

4. Sa i përket dënimeve të mëhershme të të Akuzuarit, Gjykata është e mendimit që ato në vetëvete, nuk përbëjnë rrethanë rënduese në këtë rast. Megjithatë, ato janë relevante, me t'u pranuar si dëshmi para gjykatës. Në këtë rast, Trupi gjykues shpreh pikëpamjen se fakti që i akuzuari është dënuar më herët në Gjermani për kryerjen e veprës që ka të bëjnë me narkotikë është mjaft e rëndësishme dhe shërben për të neutralizuar gati çdo lehtësim që mund të pretendojë se i takon në këtë rast. Prandaj, sa më i madh numri i dënimeve të mëhershme, aq më e madhe humbja kumulative e lehtësimit.
5. Ngjashëm, Gjykata thekson që një i akuzuar ka të drejtë që plotësisht të provojë dëshminë kundër tyre dhe ta drejtojnë rastin në mënyrën që dëshirojnë (përderisa nuk përbën abuzim të procesit) dhe që deklarimi si i pafajshëm është diçka për të cilin një person i akuzuar nuk do të dënohet kurrë. Megjithatë, neutralizon një pjesë të lehtësimit, përndryshe një akuzuar mund të ketë të drejtë për shembull duke demonstruar keqardhja, duke kursyer kohën e Gjykatës etj.

Megjithatë, Gjykata identifikon këtë rrethanë lehtësuese në këtë rast:-

1. I pandehuri është i martuar e me tre fëmijë dhe ata nuk do ta kenë praninë e babait të tyre për disa kohë në të ardhmen.

Trupi Gjykues beson që duke marrë parasysh faktorët rëndues, humbjen e lehtësimit për arsyet e cituara më lartë dhe përfundimisht faktorët lehtësues me më pak peshë, që dënimi i duhur me të cilin duhet të dënohet i pandehuri është dhjetë (10) vite burgim.

Që dënimi do të llogaritet nga data që i pandehuri ka qenë i ndaluar, që është 23 janar 2013.

I Akuzuari po ashtu është gjobitur me 20,000 EUR për shkak të peshës së veprës dhe për arsye të gjetjes së Gjykatës që ai pa dyshim është përfshirë në këtë aktivitet për profit dhe i ngarkon shpenzimet për të në shumë prej 4,600 EUR. Këto shpenzime ngarkohen në rrethanat ku, përmes avokatit të tij, i Pandehuri ka mohuar që zërat nga përgjimet janë të tija dhe Gjykata përcaktoi që, për interesin e drejtësisë, duhet të caktohet një ekspert ex officio për ta vlerësuar këtë kontestim. Pasi që eksperti ka arritur konkluzionin se i pandehuri është përgjegjës edhe për këto shpenzime. Për arsyet e cekura më sipër, Trupi gjykues vendos si në dispozitivin e këtij Atgjykimi.

Gjykatës Malcolm Simmons
Kryetar i Trupit Gjykues

Gjykatëse Franciska Fiser
Anëtar i Trupit

Gjykatës Faik Hoxha
Anëtar i Trupit

Sonila Macneil
Procesmbajtës

MJETI JURIDIK: Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Apelit e Kosovës, përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të aktgjykimit, në bazë të nenit 380 (1) i KPK-së.

ANEKSI I

Dëshmitarët

Vive Voce

A. Dëshmitarët ekspertë

P.B. i Shërbimeve të Audio Forensikës

B. Dëshmia e Ekspertit

Raporti i datës 18 dhjetor 2013 i P.B., Shërbimet e Audio Forensikës

C. Dëshmitarët e Fakteve

1. **M.L.**, Hetues Penal, Munich, RF e Gjermanisë, më herët oficer i Policisë së EULEX-it, Njësia për Hetimin e Krimin të Organizuar (NjHKO);

2. **A.S.**, Hetues Penal, R. e Turqisë, i deleguar si oficer i Policisë së EULEX-it, Njësia për Hetimin e Krimin të Organizuar (NjHKO);

ANEKSI II

Të gjitha urdhrat nga Gjykata dhe Prokurori dhe raportet përkatëse, duke përfshirë:

Dosje VI, Urdhrat dhe Kërkesat Vëllimi I:

Aktvendimi për Hapjen e Hetimit i datës 11 maj 2012, faqe 1-8

Letra e Besimit i datës 11 maj 2012, faqe 9-16

Urdhri për Përgjim i datës 16 maj 2012, faqe 29-35

Urdhra për Operatorët (Ipko, Vala, Z-Mobile), faqe 36-41

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 19 qershor 2012, faqe 55-81

Aktvendimi për Zgjerimin e hetimit i datës 26 qershor 2012, faqe 82-94

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 26 qershor 2012, faqe 117-144

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 16 korrik 2012, faqe 210-218

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 1 gusht 2012, faqe 219-224

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 2 gusht 2012, faqe 240-255

Aktvendimi i datës 2 gusht 2012, faqe 272-276

Urdhri i datës 6 gusht 2012, faqe 277-294

Urdhri i datës 26 qershor 2012, faqe 314-330

Aktvendim ndaj Ankesës së Prokurorisë i datës 23 gusht 2012, faqe 343-352

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 7 shtator 2012, faqe 367-375

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 24 shtator 2012, faqe 391-401

Urdhri i Prokurorit i datës 24 shtator 2012, faqe 402-415

Urdhri për Plotësim i datës 24 shtator 2012, faqe 416-421

Dosja VII, Kërkesat dhe Urdhrat, Vëllimi II:

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 6 tetor 2012, faqe 17-37

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 22 tetor 2012, faqe 54-74

Aktvendim për vazhdimin e Hetimeve i datës 19 nëntor 2012, faqe 87-94

Urdhri për Masa të Fshehta i datës 17 dhjetor, faqe 111-120

Urdhër arresti i datës 22 janar 2013, faqe 135-154

Urdhër bastisje i datës 22 janar 2013, faqe 170-189

Urdhër arresti i datës 22 janar 2013, faqe 203-218

Aktvendim për Paraburgim i datës 23 janar 2013, faqe 219-228

Letra e Besimit e datës 30 janar 2013, faqe 259-262

Urdhri për Shpalesje e datës 30 janar 2013, faqe 277-284

Aktvendim i Gjykatës së Apelit i datës 31 janar 2013, faqe 285-292

Aktvendim për Vazhdimin e Paraburgimit i datës 21 shkurt 2012, faqe 305-316

Urdhri për Ekzaminim i datës 22 shkurt 2012, faqe 317-324

Aktvendim i Gjykatës Supreme i datës 24 prill 2013, faqe 366-374

Aktvendim për Vazhdimin e Paraburgimit i datës 21 qershor 2013, faqe 398-409

Urdhri për Shpalesje të të Dhënave Financiare i datës 27 qershor 2013, faqe 425-440

Aktvendim i Gjykatës së Apelit i datës 5 korrik 2013, faqe 466-479

Dokumentet e Transferit të INL-së në mes të PSRK-së dhe RF të Gjermanisë

Vendimi për miratimin e transferit të procesit penal i datës 22 gusht 2012, Dosja VI, Kërkesat dhe Urdhurat Vëllimi I, faqe 331-336

Informatë mbi vendimin për miratimin transferin e procesit penal i datës 22 gusht 2012, Dosja VI, Kërkesat dhe Urdhurat Vëllimi I, faqe 337-338

Përgjigja ndaj kërkesës për transferin e procesit penal i datës 22 gusht 2012, Dosja VI, Kërkesat dhe Urdhurat Vëllimi I, faqe 339-342

Kërkesa për Mbështetje Ndërkombëtare Ligjore për Autoritetet Gjermane, Dosja VI, Kërkesat dhe Urdhurat Vëllimi I, faqe 145-194

Urdhri i Gjykatës për Bastisje dhe Konfiskim të Përkohshëm i datës 22 janar 2013, Dosja V, Dëshmitë nga Bastisjet dhe Raportet Policore të Kosovës, faqe 222-228

Të gjitha raportet policore nga RF. E Gjermanisë dhe nga NjHKO-së e EULEX-it në Kosovë

Raport i Hetimit Preliminar i datës 20 qershor 2012, Dosja V, Dëshmitë dhe Raportet e Policisë së Kosovës, faqe 38-41

Raport Hetues, Bavaria, i datës 2 korrik 2012, Dosja II, faqe 261-286

Raport Hetues, Bavaria Jugore, i datës 6 gusht 2012, Dosja II, faqe 1-16

Përmbledhja/Pasqyra në lidhje me dorëzimin e 15.kg të heroinës, i datës 12 nëntor 2012, Dosja II, faqe 17-52

Raportet Hetuese të datës 12 nëntor 2012 (Dosja II, fq 20-33, 37-52) dhe 2 korrik 2012 (Dosja II, fq 263-273, 276-286)

Raporti përfundimtar i datës 15 janar 2013, Dosja V, Dëshmitë nga Bastisjet dhe Raportet e Policisë së Kosovës, faqe 204-221

Regjistri i Detajeve të Abonuesit të Telefonit, A.V. dhe T.V., Dosja III, Tab 22

Detajet e Abonuesit për një thirrje të bërë në mes të S.V.t dhe A.V.t më 12 shkurt 2012 në ora 08:51:05, Dosja III, fq. 65A

Raporti i Abonuesit të PTK/IPKO, Dosja V, Dëshmitë nga Bastisjet dhe Raportet e Policisë së Kosovës, fq 284-295, Raport i përkohshëm mbi B.A. i datës 24 maj 2013, Dosja V, Dëshmi nga Bastisjet dhe Raportet e Policisë së Kosovës, faqe 284-295

Shpalosja e Raportit me të Dhënat Financiare, Western Union, Dosja V, faqe 296-315

Raport mbi Shpalosjen e të Dhënave Financiare për M.A.n i datës 12 korrik 2013, Dosja e Dëshmimeve nga Bastisjet dhe Raportet Policore I, faqe 296-315

Raport mbi verifikimin e personave.

Të gjitha raportet e vëzhgimit dhe fotografitë për të dyshimtët, narkotikët dhe automjetet e marra në RF të Gjermanisë.

Raport mbi aktivitetet vëzhguese më 10 qershor 2012, i datës 13 qershor 2012, Dosja II, faqe 366-369

Të dhënat në dosjen e Krasniqit në automjetin Toyota Corolla, e regjistruar mbi S.V., i datës 20 shkurt 2012, Dosja II, faqe 87-88, 105-106

Vlerësimi i provave M.K. i datës 16 gusht 2012, Dosja II, faqe 123-157

Fotoalbumi i Automjetit dhe Narkotikëve i datës 21 shkurt 2012, Dosja II, faqe 53-86

Të gjitha raportet mbi arrestimet e të dyshimtëve në RF të Gjermanisë

Të dhënat në dosjen për arrestimin e M.K. i datës 20 shkurt 2012, Dosja II, faqe 87-88, 105-106

Të dhënat në dosjen për arrestimin e L.G., Lidhësja II, faqe 29, 47

Raportet lidhur me bastisjet e të dyshimtëve të arrestuar në RF të Gjermanisë dhe raportet e provave të kapura nga pronat/automjetet e bastisura në RF të Gjermanisë.

Shënime në dosjen për bastisjen e shtëpisë, Munich, Rr. xxx i datës 28 shkurt 2012, Dosja II, faqe 87-122

Raporti i vlerësimit për gjësendet e konfiskuara në vendbanimin e M.K., i datës 28 shkurt 2012, Dosja II, faqe 94-104, 112-122

Raport bastisjeje – Kontrolli dhe Provat për Y.G. i datës 9 maj 2012, Lidhësja II, faqe 211-249

E dhënë për rastin në lidhje me bastisjen automjetit Opel, në lidhje me R.A., i datës 10 qershor 2012, Dosja II, faqe 313 – 324

Fotoalbum i Automjetit dhe Narkotikëve i datës 14 qershor 2012, Dosja II, faqe 287-312

E dhënë për rastin për R.A. i datës 14 gusht 2012, Dosja II, faqe 313-324

Raport për vlerësimin e dëshmive për R.A. i datës 31 tetor 2012, Dosja II, faqe 325-351

Raport i bastisjes dhe konfiskimit për O.B.n i datës 10 qershor 2012, Dosja II, faqe 370-373

Deklaratë për gjësendet konfiskuara për O.B.n i datës 10 qershor 2012, Dosja II, faqe 374-381

Ekzaminimi i gjësendeve të O.B. i datës 25 korrik 2012, Dosja II, faqe 382-407

Shënim në dosje për L.Z. i datës 10 korrik 2012, Dosja II, faqe 408-415

Ekzaminimi i provave për L.Z. i datës 14 gusht 2012, Dosja II, faqe 416-427

Raport bastisjeje për L.G. i datës 19 shtator 2012, Dosja II, faqe 180-210

Raportet e Forensikës për narkotikët të konfiskuar nga RF e Gjermanisë

Ekspertizë, Departamenti i Substancave Narkotike, 21 gusht 2012, Dosja II, anglisht fq. 250-255, shqip fq. 256-260

Raporti mbi Ekzaminimin e Narkotikëve i datës 4 dhjetor 2012, Dosja II, anglisht fq. 312A-312C, shqip fq. 312D-312F

Urdhri për arrest, urdhërarrest evropian, Munich, RF e Gjermanisë, për A.V.n i datës 10 shtator 2012, Dosja II, fq. 428-433

Raportet mbi bastisjen dhe arrestimin e të Pandehurit A.V. në Kosovë 23 janar 2013

Raporti i i NjHKO-së mbi bastisjen e e hapësirave të të Pandehurit A.V. në Prishtinë dhe në automjet, Kosovë i datës 24 janar 2013, Dosja V, Dëshmi nga Bastisjet dhe raportet e Policisë së Kosovës, faqe 236-268

Raport për pasaportën e konfiskuar të A.V., Dosja V, Dëshmi dhe Bastisjet dhe raportet e Policisë së Kosovës, fq. 275-279

Raport për arrestin e A.V. i datës 24 janar 2012, Lidhësja V, Dëshmi nga Bastisjet dhe raportet e Policisë së Kosovës, fq. 230-235.

Përgjimet

Përgjimet e realizuara në mes të janar 2012 deri tetor 2012 nga Policia gjermane dhe nga NjHKO e EULEX-it

Të gjitha përgjimet, audioincizimet dhe transkriptet relevante, duke përfshirë mesazhet SMS

Urdhrat e gjykatës për përgjim, Gjermani, Lidhësja III, Tab 23

Transkriptet e përgjimit, Dosja IV

Raportet policore mbi përgjimet e ligjshme të linjave të ndryshme telefonike nga RF e Gjermanisë, Dosja IV

Raportet policore mbi përgjimin e telekomunikimit në Kosovë

Dosja V, dëshmi nga Bastisjet dhe raportet policore në Kosovë, që përbën këto:

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 4 qershor 2012 i përgjimeve për periudhën 18 maj – 1 qershor 2012, faqe 7-15

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 16 qershor 2012 i përgjimeve për periudhën 2 qershor – 16 qershor 2012, faqe 22-28

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 1 korrik 2012 për periudhën 17 qershor – 1 korrik 2012, faqe 42-47

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 16 korrik 2012 për periudhën 1 korrik – 16 korrik 2012, faqe 52-57

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 1 gusht 2012 për periudhën 17 korrik – 31 korrik 2012, faqe 76-81

Raport i përkohshëm i përpilimit i datës 2 gusht 2012, faqe 82-85

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 16 gusht 2012 i përgjimit për periudhën 1 gusht – 15 gusht 2012, faqe 90-98

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 31 gusht 2012 i përgjimit për periudhën 16 gusht – 31 gusht 2012, faqe 108-122

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 16 shtator 2012 i përgjimit për periudhën 1 shtator – 16 shtator 2012, faqe 123-126

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 1 tetor 2012 i përgjimit për periudhën 17 shtator-1 tetor 2012, faqe 146-154

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 15 tetor 2012 i përgjimit për periudhën 1 tetor – 15 tetor 2012, faqe 161-169

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 30 tetor 2012 i përgjimit për periudhën 16 tetor – 30 tetor 2012, faqe 170-175

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 15 nëntor 2012 i përgjimit për periudhën 1 nëntor – 15 nëntor 2012, faqe 176-179

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 5 dhjetor 2012 i përgjimit për periudhën 16 nëntor – 1 dhjetor 2012, faqe 180-183

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 17 dhjetor 2012 i përgjimit për periudhën 1 dhjetor -15 dhjetor 2012, faqe 190-195

Raport 15 ditor i NjHKO-së i datës 2 janar 2013 i përgjimit për periudhën 15 dhjetor 2012 – 1 janar 2013, faqe 196- 199

Deklaratat e të Pandehurit

Dëshmia gjatë procedurës paraprake e të Pandehurit A.V. para Prokurori i datës 15 maj 2013, Lidhësja V, faqe 316-330 dhe

Dëshmia gjatë procedurës paraprake e të Pandehurit A.V. para Prokurorit i datës 30 maj 2013, Lidhësja V, faqe 345-358

Dokumentet tjera

Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Munich në rastin nr. 3 KLS 371 Js 117752/12

Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Munich në rastin nr. 3 KLS 371 Js 157244/13

PED – Raport i ekzaminimit të dëshmive i Njësisë së Forensikës së IT-së në NjHKO.

Letër e datës 7 shkurt 2013 nga ARBK A,S.-it

Letër e datës 8 shkurt 2013 nga Ministria e Financave e Kosovës për A,S.-in

Letër e datës 8 shkurt 2013 nga Banka Ekonomike Gjykatës Themelore të Prishtinës

Letër e datës 7 shkurt 2013 nga DMTH Gjykatës Themelore të Prishtinës

Letër e datës 12 shkurt 2013 nga Raiffeisen Bank Gjykatës Themelore të Prishtinës

Letër e datës 15 shkurt 2013 nga Banka për Biznes Gjykatës Themelore të Prishtinës

Letër e datës 6 shkurt 2013 nga BKT Gjykatës Themelore të Prishtinës

Raport i shqyrtimit të dëshmive (Njësia e Forensikës së IT) i datës 13 mars 2013

Ekstrakt nga Regjistri Qendror Federal i datës 21 maj 2013

i Gjykata Supreme e Kosovës Referenca Ap-Kz nr. 61/2012; 02 Tetor 2012

ii Referenca e Gjykatës së Apelit PAKR 4/2013

iii Paragrafi 53 i KP, duke miratuar arsyetimin e paragrafit 48 të SA

iv Arsyetimi i paragrafit 55 të Aktgjykimit J.P.